



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë

Master Profesional

“Administrim Biznesi i Avancuar”, me profile: a. Menaxhim; b. Kontabilitet - Financë; c. E Drejtë Biznesi

i

Institucionit të Arsimit të Lartë “Tirana Business University College”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Halit XHAFA

Dr. Irma SHYLE

Janar 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master Profesional “Administrim Biznesi i Avancuar ” me profile: a-Menaxhim, b-
Kontabilitet-Financë, c- E Drejtë Biznesi

Nr.		
1	IAL aplikues:	Tirana Business University College
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Menaxhimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Administrim Biznesi me profile: a-Menaxhim, b- Kontabilitet-Financë, c-E Drejtë Biznesi
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr.386 datë 05.08. 2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresë Nr. 3575/3 prot, datë 07.05.2019
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	13/5
18	Numri i studentëve:	30
19	Komente / të tjera:	




TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznesi i Avancuar, me profile, ofrohet nga, Fakulteti i Administrim Biznesit i TBU me njësi bazë përgjegjëse Departamentin e Menaxhimit.

Raporti i Vlerësimit nga Ekspertët e Jashtëm, përshkruan analizën mbi treguesit e matshëm, si dhe shkallën e përmbushjes së standarteve sipas kërkesave të cilësisë së ASCAL dhe nëse programi është në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave të TBU. Programi ofrohet me tre profile: Menaxhim, Kontabilitet- Financë dhe E Drejtë Biznesi.

TBU ushtron aktivitetin ekonomik mbështetur në VKM nr.794 datë 6.10.2010, me Urdherin e MASH Nr. 75, datë 16. 02. 2011. Me vendimin e akreditimit institucional 506 datë 18.7.2013 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, me urdhërin e MASH nr.326 datë 15.8.2013 është bërë akreditimi institucional dhe i programeve.

Në zbatim të ligjit 80/2015 datë 22.07.2015, Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë “neni 75 pika 6 u riorganizua programi ekzistues Master Profesional i Avancuar me 90 kredite respektivisht në 60 dhe 120 kredite. Për këtë qëllim Senati Akademik i TBU me vendimin 33 datë 17.06.2016 riorganizoi, përkatësisht në Master Profesional 60 kredite me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë dhe 120 kredite me profile Menaxhim, Kontabilitet-Financë dhe E drejtë Biznesi. Në mbështetje të riorganizimit të programeve u hartuan rregulloret përkatëse, planet dhe programet e studimit.

RVJ i referohet ecurisë së programit të studimit Master Profesional në Administrim Biznesi i Avancuar, me profile: "Menaxhim", "Kontabilitet-Finance" dhe "E Drejte Biznesi". për vitet 2018-2019 e në vijim. Afati i studimeve për këtë program është 2 vite. Praktika profesionale shtrihet gjatë dy viteve akademike.

Realizimi programit mbështetet me infrastrukturën dhe financimin e nevojshëm si dhe me staf akademik me përvojë pedagogjike e akademike dhe profesionale në fushat përkatëse.

Ky program studimi e ka origjinen nga programi MP në "Administrim Biznesi", me profil "Kontabilitet - Finance", dhe "Administrim Biznesi" me profil "E Drejte Biznesi", i licensuar sipas Urdherit te MASH Nr. 386, date 05.08.2011 dhe akredituar me Urdher te MASH Nr. 326, date 15.08.2013. Sipas Vendimit te Senatit Nr.33, date 17.06.2016, institucioni i riorganizon keto programe në Master Profesional Administrim Biznesi me profil; Finance -Kontabilitet, me 120 ects dhe 60 ects, Master Profesional Administrim Biznesi me profil Menaxhim me 120 ects dhe 60 ects dhe Master Profesional Administrim Biznesi me profil E Drejte Biznesi me 120 ects. Pas disa komunikimeve me TBU dhe MASR mbi riorganizimin e programeve, institucioni paraqiti vendimin e senatit dhe miratimin nga MASR mbi ndryshimin e emërimit të programeve dhe kreditet. Sipas vendimit te Senatit Nr. 2, date 20.03.2019 dhe miratimit nga MASR me anë të shkreses me Nr. 3575/3 prot, datë 07.05.2019, programet/profilet e MP të percaktuar në vendimin e Senatit Nr. 33, datë 17.06.2016 ndryshojnë emertimin si vijon: MP në "Administrim Biznesi i Avancuar" me profile: i) "Menaxhim"; ii) Kontabilitet-Finance"; iii)E drejte Biznesi. Sipas këtij vendimi ky program studimi ofrohet me 120 kredite.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

GVJ gjatë vlerësimit të programit është mbështetur në kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë, aktet ligjore dhe nënligjore mbi të cilat funksionon e operon programi, statutet e rregulloret e hartuara e miratuara në TBU, vlerësimin e hapave të bërë dhe progresit të arritur, duke u mbështetur në RVB, rezultatet e vizitës në institucion dhe të dhënat sasiore e cilësore të siguruara gjatë vizitës dhe online në faqen përkatëse të ASCAL.vecanerisht RVB, Raportit të NJBSC, anekset dhe tabelat që shoqërojnë e ilustrojnë gjetjet e trajtimet e RVB dhe komentet përkatëse.

GVJ në këtë proces ka vlerësuar programin, përputhjen e tij me objektivat strategjike të njësisë kryesore dhe bazë, kërkesat e tregut, personelin akademik të angazhuar, ndërveprimin e njësisë bazë përgjegjëse me ato mbështetëse, burimet financiare dhe infrastrukturën.

GVJ i përbërë nga Prof. Halit Xhafa dhe Dr. Irma Shyle me asistencën e koordinatorit teknik të ASCAL, në datat 01 dhe 02 Tetor 2020, realizuan vizitat në institucion sipas agjendës së parapërcaktuar.

Më datë 18.12.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 53/22 Prot., datë 18.12.2020, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 04.01.2020 dhe me shkresë Nr. 21/11 Prot., datë 04.01.2020.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin I.1, Kriteri 4 :

GVJ vlerëson partneritetet që ka institucioni me kompani të ndryshme të cilat ofrojnë mundësi intershipi dhe punësimi për studentët. GVJ në draft raportin e dorëzuar, në pjesën e parë të komenteve të bëra për këtë kriter, ka sqaruar se edhe pse nga institucioni konsiderohet si analizë tregu e bërë para hapjes së programit të studimit apo edhe një analizë tjetër e tregut të punës për studentët e diplomuar në vitin akademik 2018-2019, në fakt nuk janë analiza të mirëfillta të tregut të punës. Sidoqoftë në tregun e këtij programi janë mbi 20 programe të peraferta në IAL publike dhe jo publike, të gjithë prodhojnë diplomën master profesional bile edhe mjaft diplomime janë edhe në universitete të huaja, etj, konkurrenca është e ranishme dhe në rritje, risku vjen duke u rritur pavarësisht nga komoditeti i momentit apo edhe për pak vite të TBU në këto aspekte.

Raporti në këtë pikë ndryshon. Vlerësimi për standardin 1 ndryshon.

2. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin I.3, Kriteri 1:

Për komentin e IAL gjykojmë se vlen i njëjti qëndrim. Kontigjentet e vogla të studentëve sot dhe ato të synuara nga IAL dhe rrjeti i madh i bashkepunetoreve biznese nuk e kanë evidentuar problemin e punësimit i cili është mjaftuar me testimin e njohjen e tregut nëpërmjet anketimeve, lidhjeve me bizneset, aktivizimit të personaliteteve nga bizneset në aktivitete të TBU, etj. Sic theksohet në raportin e RVJ në treg janë mbi 20 IAL të tjera që prodhojnë këto diplome në kontigjente të konsiderueshme, pra komoditeti aktual dhe për pak vite do të zbehet dhe risku i kontigjenteve do të rritet prandaj kerkohet një analizë e plot tregu, mbase ehe duke shfrytëzuar ato në shkallë kombëtare të inicuar nga MARS.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

3. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin I.3, Kriteri 2: GVJ ka të njëjtin arsyetim si në kriterin 1.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.



4. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ Kriteri 3 GVJ ka bere dy konstatime qe duhen ripare: titullimi i programit Master profesional i avancuar dhe prezencen e profilit e drejte biznesi në një program masteri me formim baze ekonomik. Pavarësisht komenteve te IAL, GVJ i përmbahet komenteve të bëra në draftin e parë.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

5. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin I.3, Kriteri 4:
GVJ sugjeron se programi ka vend për rishikime duke u krahasuar me programe të ngjashme profesionale në tregun lokal, dhe në tregje gjeografikisht afër me shtetin tonë, si në Ballkan dhe BE, për të rritur konkurrueshmërinë e studentëve.
Kommentet e IAL nuk adresojnë programet e tregut lokal dhe rajonal, për të mundësuar të bëjnë diferencën në strukturë, përmbajtje etj.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

6. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin I.3, Kriteri 7:
GVJ sugjeron edhe prezencën dhe shfrytëzimin më shumë të literaturës shqip dhe prezencën e tyre në bibliotekën e institucionit. Ky koment riformulohet nga ana jonë pasi lidhet me mundësinë e ofrimit të programeve në gjuhë të huaj.

Raporti në këtë pikë ndryshon.

7. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin I.3, Kriteri 8:
GVJ ka sugjeruar se duhen rishikuar syllabluset dhe të mos jenë të njëta për nivelin bachelor dhe master sic u konstatua në lëndët manaxhimi strategjik, menaxhimi sistemeve të informacionit, vlerësimi i projekteve, qeverisja e korporatës, biznesi ndërkombëtar, manaxhimi strategjik, menaxhimi operacioneve, menaxhimi i cilësisë, menaxhimi i marëdhënies me klientin, marketingu ndërkombëtar, etj.
Pavarësisht komenteve te IAL, GVJ gjykon se kjo është kerkese akademike e padiskutueshme dhe qe lidhet me formimin e studenteve dhe menyren e zhvillimit te mesimdhenes dhe mesimnxenies.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

8. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin I.4, Kriteri 2 dhe 3:
Standarti 1.4 kriteri 2 dhe 3 kërkon përputhjen e fushës së përgjithshme e specifike të programit me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë. Për këtë qëllim GVJ ka sugjeruar se profili e Drejtë biznesi mund dhe duhet të ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë në TBU dhe jo nga Fakulteti i Biznesit.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

9. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin I.5, Kriteri 1:
GVJ gjykon se ky kriter lidhet me bashkepunimin brenda institucionit, analizen e vazhdueshme te punës. Analiza e punës, evidentimi i problemeve, rekomandimet për persosje janë pjesë e pergjegjesive dhe permiresimeve. Sic theksohet në konstatimin e GVJ, keto analiza, impaktime nga studente dhe vete departamentet nuk u gjeten në analizat e punes në institucion.



Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

10. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin I.5, Kriteri 3:
GVJ gjykon se komenti mbi kriterin 3 lidhur me ndjekjen dhe realizimin e praktikave. Komentet e IAL qartësojnë zhvillimin e praktikave për një periudhë dy vjeçare të ndara në cdo javë dhe ndjekje permanente sipas programeve, specifike kjo për TBU që ka bashkëpunim me një rrjet të gjere të partnereve private e publike. Si e tille ajo plotësohet.

Raporti në këtë pikë ndryshon.

11. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin I.5, Kriteri 5:
GVJ gjykon se lidhur me trajnimet profesionale për studentët e diplomuar ndër vite, konsiderohet disi i plotësuar në forma të tjera si larmi aktivitetesh, fteses së studenteve në aktivitete të alumni, bashkëpunimi me akademine e grupit Balfin për kurse të shkurtra trainimi, etj.

Raporti në këtë pikë ndryshon.

12. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.1, Kriteri 3:
GVJ mendon se ky program duhet të shmangë pjesën e thelluar akademike dhe të fokusohet në aftësimin teoriko-praktik dhe kompetenca profesionale në fusha respektive e jo thellimi akademik. Kjo vihet re në disa lende edhe nga literatura e rekomanduar për cdo kapitull në anglisht e pranishme në syllabluse.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

13. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.1, Kriteri 6:
GVJ ka konstatuar se shpërndarja e krediteve është bërë në mënyrë uniforme nga 6 kredite, nuk është bërë ndarja e krediteve sipas elementëve të detyrimeve, cituar edhe në vendimin e dekanit të fakultetit, etj. Ndonese është respektuar grupimi i lëndëve sipas kontributit në formim, sic e kërkon edhe ligji, pesha e cdo lënde mbështetur në natyrë e lëndës, përmbajtjen, raportin teori, situata ushtrimesh e rastesh studimi etj, mbështetur edhe në përvojat e universiteteve përëndimore, dhe rrjeti i oreve në dispozicion për cdo lëndë diferencohen.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

14. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.2, Kriteri 1: GVJ rithekson arsyetimet e bëra në standartin II. 1 kriteri 6

Raporti në këtë pike nuk ndryshon.

15. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.2, Kriteri 7: GVJ vlereson komentet e bëra nga IAL për hapat e ndjekura ng IAL për kalimin e programit nga 90 kredite në 120 kredite, në kuadrin e riorganizimit të programit, pra e konsideron disi të plotësuar riformatimin e numrit dhe emertimit të lëndëve.

Raporti në këtë pikë ndryshon

16. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.3, Kriteri 1: GVJ rithekson komentin më sipër si i vlefshëm edhe për të arsyetuar ndryshimet e planit mësimor, nga sistemi 90 kredite në 120 kredite dhe si i tillë:



Raporti në këtë pikë ndryshon

17. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.3, Kriteri 3: GVJ mendon se reduktimi i numurit të lëndëve të paraqitura në syllabluse, shumë më tepër se ato në planin mësimor, riklasifikimi sipas kontributit në formim i tyre, prania e lëndëve me zgjedhje në planin mësimor, dhe i disa lëndëve të formimit bazë si ekonomiks, si dhe ekonometri, apo metoda kerkimi, qoftë edhe më zgjedhje kopletojnë programin në formimin, metodologjinë dhe kontribuojnë në cilësinë e lëndëve pasardhëse.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

18. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.3, Kriteri 4: GVJ gjykon se shpërndarja e pikëve të vleresimit sipas elementve të detyrimeve është e panegociueshme për cdo lëndë, përkundrazi, vendos në një disiplinë akademike dhe interpretimi cdo pedagog e lëndë dhe shmang subjektivizmin në vlerësim.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

19. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.3, Kriteri 6: GVJ e heq këtë koment nga raporti pasi është trajtuar në standartin II.1 kriteri 1

Raporti në këtë pikë ndryshon.

20. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.4, Kriteri 2: GVJ i qëndron komentit të bërë mbi mos diferencimi i syllabluseve përsa i përket objektivave, literaturës, mënyrës së kontrollit të dijeve, detyrimeve, etj. me sistemin bachelor.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

21. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.4, Kriteri 3: GVJ e vlereson fleksibilitetin që i jep programi cdo studentit në funksion të vendit të tij të punës, interesave të karrierës. Por numuri i vogël i studentëve bën që lëndët që i caktohen cdo studentit të ndiqen e shlyhen thjesht me seanca konsultimi dhe rekomandimi materialesh dhe jo të formuara në grupe me mbi 10 studentë ku të kete mundësi lektorimi dhe puna me seminare apo grupe studimi të përbashkëta, pra sic është konceptuar orientohet drejt një plani individual studimi për disa studentë.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

22. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.4, Kriteri 4: GVJ 4 perserit komentin e bere në standartin 1.3 kritei 4 se programi ka vend për rishikime duke u krahasuar me programe të ngjashme profesionale në tregun lokal, dhe në tregje gjeografikisht afër me shtetin tonë, si në Ballkan dhe BE, për të rritur konkurrueshmërinë e studentëve.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

23. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.5, Kriteri 1 dhe 2: GVJ konstaton se fondi i oreve që mbulon stafi me tituj e grada shkencore në program është më i vogël se fondi orëve që përmban programi, pra diferenca është mbuluar me staf që ka kualifikim të njëjtë më atë që synon programi.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.



25. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.6, Kriteri 1: GVJ rithekson nëvojen e terheqjes se komenteve, feedback dhe opinioneve te tregut te punes per cilesine e programit, njohurite dhe lendet

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

26. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.6, Kriteri 4: GVJ respekton qëndrimin që mban për standartin II.3 kriteri 1.

Raporti në këtë pikë ndryshon.

27. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin III.7, Kriteri 1: GVJ vlereson se komenti i bërë në RVJ për këtë kriter është komentuar e vlerësuar në standartin II.3 kriteri 2.

Raporti në këtë pikë ndryshon.

28. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin III.8, Kriteri 3: GVJ ka rekomanduar një rishikim të numrit te krediteve, pasi kreditet qe fitohen nga praktika dhe punimi i diplomes jane 48 kundrejt 120 te gjithë programit. Meqenese ky është master profesional dhe aftesimi praktik është karakteristike dalluese e këtij programi GVJ i konsideron te pranueshem por jo shterues komentet e IAL, duke besuar se në kuadrin e rishikimeve periodike te programeve do te arsyetoje mbi kete konstatim.

Raporti në këtë pikë ndryshon.

29. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin IV.1, Kriteri 3 dhe 4: GVJ i ka dhënë sqarimet për këtë kriter në raport. Në të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni apo edhe gjatë takimit në institucion nuk gjetëm informacion për rekrutimin e stafit akademik PAE dhe PAK, për procedurat e ndjekura etj.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

30. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin VI.1, Kriteri 4: GVJ duke u bazuar edhe në dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion nga institucioni, gjykon se NJSBC ka një plan kalendarik në të cilin të parashikohet plani i veprimit, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse.

Raporti në këtë pikë ndryshon. Standarti VI.1 ndryshon nga përmbushet kryesisht në përmbushet plotësisht.

31. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin VI.2, Kriteri 3, 4 dhe 5: GVJ bazuar edhe në dokumentacionin shtesë të dërguar nga institucioni, evidenton se Institucioni i arsimit të lartë nuk përdor mjaftueshëm metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

32. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin VI.3, Kriteri 2, 3 dhe 4: GVJ sikurse edhe është shprehur më sipër, nuk evidenton ndonjë metodë të drejtpërdrejtë, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime



paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës,

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

33. Për komentit e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin VI.4, Kriteri 5: GVJ evidenton se nuk ka asnjë dokumentacion për tju referuar komentit që institucioni ka bërë në lidhje me ekspertët e huaj.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional
“Administrim Biznesi i Avancuar”, me profile: a. Menaxhim; b.
Kontabilitet - Financë; c. E Drejtë Biznesi**

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Programet e studimit të ofruara nga TBU janë në harmoni dhe nuk bien ndesh me politikat kombëtare, duke synuar punësimin, sipërmarrjen inovacionin.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznesi i Avancuar me profile; Menaxhim, Kontabilitet-Financë dhe E drejtë biznesi, përmban lëndë dhe kurrikula, të cilat janë në përputhje me interesat kombëtare. Plani strategjik i programit, synon të përgatisë studentë që të bëhen qytetarë të mirë, specialistë të aftë në menaxhimin e biznesit, të financave të tij dhe të problemeve ligjore me të cilat ndeshen bizneset tona të mëdha, mesme apo të vogla. udhëheqës të përgatitur në të ardhmen e të orientuar drejt zgjidhjeve të problematikave në çështjet lokale, rajonale dhe kombëtare”.</p> <p><i>Aneks 3.1 Strategjia e zhvillimit të TBU 2018.</i></p>
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Ky program studimi është hartuar në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në Shqipëri. Plani strategjik i programit synojnë në konsolidimin e vlerave akademike kulturore e kombëtare, ai është në përputhje me statutin e TBU dhe ka synim përgatitjen profesionale cilësore të studentëve duke ndërtuar raport të drejtë midis aftësisimit teorik e praktik, në administrimin, financat dhe të drejtën e biznesit.</p> <p><i>Statuti TBU neni 8 aneksi 22.</i> <i>Aneksi 4 _Plani strategjik MP AB_ 2018-2021</i></p>
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi Master Profesional në Administrim Biznesi i Avancuar, me profile, synon përgatitjen e menaxherëve dhe administratorëve të profilizuar në menaxhim, kontabilitet-financë dhe të drejtë biznesi. me njohuri teorike dhe shprehje praktike të aftë për tregun ku operon biznesi i tyre, mjedisin ku ai operon dhe konkuron dhe të aftë të pranohen e kërkohen nga tregu.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit është mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM 41/2018 për elementët e studimit, në udhëzimet 15 dhe 31 të MASR, në Kodin e Cilësisë TBU, në manualin e ASCAL për vlerësimin e cilësisë si edhe në statutin dhe rregulloren TBU dhe në rregulloren e Fakultetit të Biznesit. GVJ konstatoi se ky program studimi është hartuar në përputhje me misionin</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	dhe qëllimet e TBU ku në qendër është studenti. Kjo u konstatua gjatë shqyrtimit të materialeve të DVV, si dhe gjatë takimeve me vetë studentët dhe stafin akademik, në ditët e vizitave në institucion.			
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion, GVJ konstaton se për hapjen e këtij programi studimi nga institucioni është zhvilluar një analizë tregu në formën e një Plan Biznesi i dorëzuar përpara hapjes në MAS në vitin 2010. Kjo analizë përmban më tepër një analizë të tregut të arsimit të lartë si edhe një analizë SWOT të institucionit. Sipas kësaj analize, numri i gjimnazistëve që përfundojnë studimet e tyre do të rritet duke rritur kështu edhe mundësinë e institucioneve private të arsimit të lartë për ti përthithur këta gjimnazistë duke u bazuar edhe në kushtet dhe infrastrukturën e ofruar prej këtyre institucioneve. Gjithashtu, në vitin 2020, nga institucioni është realizuar një analizë tjetër e tregut të punës për studentët e diplomuar në vitin akademik 2018-2019 për të parë nëse studentët e diplomuar janë të punësuar apo jo dhe sa prej tyre janë të diplomuar në profilin e tyre të studimeve. Sipas këtij studimi rezulton se pjesa më e madhe e studentëve (93%) të diplomuar në vitin akademik 2018-2019 në programin e studimit MP në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, janë të punësuar në përputhje me profilin e programit të studimit që ata janë diplomuar. <i>Aneks 16. Analiza e tregut te punes para hapjes</i> <i>Aneks 17. Studimi per tregun e punes, Janar 2020</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ vlerëson se ky program studimi, është në përputhje e në zbatim me planin strategjik të TBU. Strategjia e institucionit synon ofrimin e programeve studimore në përputhje me nevojat e tregut të punës, si dhe saktëson si prioritete “garantimin e përgatitjes cilësore dhe suksesit të studentëve, ekselencë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor dhe pjesëmarrje intensive në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare”. Plani strategjik i programit është në përputhje me planin strategjik institucional sipas prioriteteve të vendosura e të sipërpërmendura. <i>Aneksi 4_Plani strategjik MP AB_ 2018-2021.</i> <i>Aneksi 7_Rreg_progr_stud_Mp_AB i Avancuar.</i>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se	Bazuar në analizën e dokumentave strategjike të institucionit, (Statuti, Plani Strategjik, Rregullorja e Fakultetit të Biznesit dhe Departamentit), dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se ky program studimi është hartuar duke u mbështetur në këto dokumenta. Pra ky program ndjek dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>zbaton misionin, qëllimin, metodat, dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit</p> <p>Sipas statutit të TBU (Aneksi 2, neni 1): fusha e administrimit të biznesit është drejtimi prioritar i TBU. Për implementimin me sukses të programit, njësia bazë ka hartuar rregulloren e programi të studimit Master Profesional në Administrim Biznesi i Avancuar me 3 profile (Aneksi 7). Bazë për hartimin e rregullores është statuti i TBU.</p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Ky program studimi është në zbatim të VKM nr 41 Dt.24.01.2018. Programi ofrohet nga Departamenti Manaxhimit, Fakulteti i Administrim Biznesit, dhe është në përputhje me fushat e drejtimet akademike të TBU, me misionin dhe qëllimin e institucionit, të cilat janë të shprehura në planin strategjik të tij.</p> <p>Programi lidhet me një nga prioritetet e TBU, është ndërtuar sipas kërkesave të VKM të sipërcituar, përmban të gjithë elementët e nevojshëm strukturorë si elementët mësimore, lëndët, syllabuset përkatës ndërtuar sipas strukturës së caktuar, disiplinat me kreditet përkatëse, (në total për ç’do lëndë dhe jo të specifikuar sipas elementëve të syllabuseve e detyrimeve vjetore) rreshtimi i lëndëve sipas kontributit në formimin e studentëve, orët mësimore dhe ato jashtë auditorit, praktika mësimore, lëndë profili sipas fushave të programit, etj.</p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Strategjisë së Zhvillimit të TBU 2018-2024, (aneksi 3.1), Planit Strategjik të MPABA me profilet për vitet 2018-2021 (aneksi 4) dhe Rregullores së Programit të Studimit MPABA programi i studimit në shqyrtim është hartuar sipas studimit të tregut të përgatitur nga institucioni. Sipas rregullores së programit, synohet të përgatiten administratorë në fushën e menaxhimit, kontabilitet-financës dhe të së drejtës së biznesit, për menaxhimin e subjekteve të ndryshme të biznesit, por edhe për sektorë të tjerë si subjektet publike por edhe subjektet jo fitimprurëse. Ky program synon tregun e punës në fushën e menaxhimit të biznesit, financave të tij, kontabilitetit dhe të drejtës së biznesit për bizneset e vogla, të mesme dhe të mëdha. Vetë ndërtimi i programit mundëson njohuri bazë dhe të avancuara në këtë drejtim. GVJ konstatoi se TBU në strategjinë dhe synimet e saj ka synuar aftësimin praktik të studentëve. Prania e punimeve vjetore, e pedagogëve dhe ekspertëve nga fusha të caktuara, punësimi i studentëve që gjatë studimeve Bachelor e Master, mënyra e vlerësimit, etj, synojnë aftësimin praktik të studentëve dhe rrisin kompetencën dhe ekspertizën e tyre, të kërkuar nga tregu.</p> <p><i>Aneksi 7_Rreg_progr_stud_Mp_AB i Avancuar.</i> <i>Aneksi 14 Dosja e plote e programit të studimit me elementet perberes te tij.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.3

Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të studimit rezultojnë se ky program ka si mision: përgatitjen e profesionistëve të fushës së manaxhimit, bankës dhe finances, kontabilitetit dhe të drejtës së biznesit, me standartet akademike të tilla që t’i përgjigjen tregut të punës dhe zhvillimeve të vazhdueshme të ekonomisë.</p> <p>Ndër objektivat formues të programit përfshihen dijet, kompetencat dhe aftësitë që studentët e programit duhet të fitojnë në përfundim të tij dhe këto janë në përputhje me atë që kërkon tregu, sipas studimit fillestar të kryer. Duhet shënuar gjithësesi së kërkesa e tregut është përcaktuar në një studim të tregut të punës përpara hapjes së programit, në 2009, ai nuk përfshin ofertën e operatoreve të tjerë në treg dhe si e tillë është e cekët. Në dijeninë tone MASR është angazhuar për një studim tregu në të gjitha fushat që do të mundësojë me informacion dhe objektiva një studim tregu specifik për produktin e TBU, mbi bazën e të cilave ka përcaktuar edhe kuota për vitet në vazhdim</p> <p>Institucioni ka bërë e depozituar edhe një studim tregu për studentët e diplomuar 2018-2019, mbështetur në anketime dhe vlerësimin e BB dhe BSH mbi bazën e të cilave ka përcaktuar edhe kuota për vitet në vazhdim (Aneksi 17)</p> <p><i>Ndonëse kjo mangësi nuk është ndjerë, kjo për shkak të nivelit të lartë të punësimit të studentëve të TBU, dhe angazhimit të bizneseve partnere, gjykojmë se duhet t’i paraprihet për rritjen e ardhshme të kontigjenteve të pranimeve të synuara në strategjinë e zhvillimit. Në studim duhet përfshirë edhe produkti i aktorëve të tjerë në treg, universiteteve publike e private konkurente dhe aspekteve demografike dhe lëvizjes mekanike të popullsisë, emigracionit, etj që gjykojmë se kopromentojnë kërkesën për vitet e ardhëshme dhe kontigjentet e mundëshme të pranimit në TBU</i></p> <p><i>GVJ mendon se institucioni i ka forcat dhe kapacitetet, si dhe aksesin për një studim të plotë e cilësor tregu që mund të orientojë në plotësimin e programeve, rishikimin e tij, profile të reja, etj.</i></p> <p>Duke iu referuar rregullores së programit, (Aneksi 7 neni 3), qëllimi i programit është përgatitja në kohë të shkurtër e profesionistëve si manaxherë, kontabilistë, financierë, bankierë, e profesionistë të së drejtës së biznesit.</p> <p>Specialistët e diplomuar nga ky program, duhet të marrin përsipër menaxhimin dhe drejtimin e subjekteve të biznesit, të sektorit publik, apo edhe subjekteve jo fitimprurëse.</p> <p>GVJ nënvizon si objektiv të qënësishëm të programit, ngjitjen në karrierë të studentëve që para mbarimit të studimeve.</p> <p><i>Gjykojmë se ky objektiv ndonëse është mjaft atraktiv është vështirë të realizohet veçanërisht me studentë të punësuar jashtë kompanive partnere e si i tillë ndonëse në mjaft raste është plotësuar, ka natyrë deklarative.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë</p>	<p>Institucioni ka kryer një studim paraprak tregu përpara hapjes së programit dhe ka bërë disa kërkime për të evidentuar më tej kërkesën. Institucioni siç e theksuam edhe mësipër në kriterin 1, institucioni nuk disponon të dhëna të analizuara dhe konkluzione konkrete të një studimi të mirëfilltë tregu për të parë edhe zhvillimet e pritshme të sektorit të financës në mënyrë</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>periodike dhe kontigjentet që mund të aplikojnë në TBU duke patur parasysh ecurinë e faktorëve të tjerë në treg dhe faktorët demografikë etj.</p> <p>Në nivelin e lartë të punësimit siç është bindja dhe praktika në institucion me të cilën pajtohem edhe ne si GVJ është numëri i vogël i pranimeve, aksesit në bizneset partnere, apo edhe bashkeaksionerë të TBU si grupi Balfin, angazhimi i strukturave të TBU, angazhimit të pedagogëve, strukturave të karrierës, aktivitete të tjera me synim prezantimin dhe aftësimin e specialistëve që diplomohen nga TBU, etj në punësimin dhe karrierën e studentëve të këtij programi.</p> <p><i>GVJ rekomandon, të analizohen më tej të dhënat e punësimit kërkesa dhe oferta e gjithë aktorëve në treg, pranimet në rritje të realizuara e sidomos ato të synuara në strategjinë e zhvillimit të TBU dhe programit, dhe ato duhet të përkthehen në strategji për përmirësimin e programit të studimit në aspektin e objektivave dhe të mundësive të punësimit që ky program ofron.</i></p> <p><i>Aneksi 6_Rregullore njësisë bazë_TBU.pdf</i> <i>Aneksi 7_Rreg_prog_stud_Mp_AB i Avancuar.</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Ky programi studimi ka objektiva formues të përcaktuar qartë që konsistojnë në rritjen e kapacitetit, të aftësive dhe të profesionalizmit të studentit që ose gjëndet ose do të hyjë pas këtij programi në tregun e punës. Sipas vendimit të Senatit Nr. 2, datë 20.03.2019 dhe miratimit nga MASR me anë të shkresës me nr. 3575/3 prot, datë 07.05.2019, programet/profilet e MP të përcaktuara në vendimin e Senatit nr. 33, datë 17.06.2016 ndryshojnë emërtimin si vijon: MP në "Administrim Biznesi i Avancuar" me profile: i) Menaxhim; ii) Kontabilitet-Finance; iii) E drejtë Biznesi; Sipas këtij vendimi ky program studimi ofrohet me 120 kredite.</p> <p><i>GVJ sugjeron, që titulli i programit me termin i avancuar mendojme se është i panevojshëm dhe nuk haset në kurrikula. Nëse synimi i programit është thellimi i njohurive nga ato në bachelor, realizohet me kurrikula në module apo krerë të caktuar, apo edhe literaturën dhe mënyrën e zhvillimit të lëndëve,</i></p> <p><i>Në kurrikulën e këtij programi, përsa i përket profileve përfshihet profili e drejtë biznesi. Pa nënvlerësuar cilësinë e lëndëve në këtë profil, stafin e angazhuar, studentët e pranuar, etj, gjykojmë se nuk respektohet kriteri akademik dhe shkencor që nga një fakultet me formim bazë dhe karakterizues me lëndë të mirëfillta biznesi, të derivojë një profil që trugun e tij akademik e ka në fakultetin e drejtësisë që ekziston në TBU. Studentët e këtij profili duhet të marrin formimin thelbësor si juristë dhe disiplinat ekonomike duhet të jenë në funksion të profilit të tyre në fakultetin bazë që në këtë rast është ai i drejtësisë.</i></p> <p>Objektivat e këtij programi studimi, struktura dhe përmbajtja e programit e mbështesin objektivin kryesor të strategjisë së zhvillimit TBU: 75% e studentëve të jenë të punësuar në profil para se të diplomohen. Në funksion të këtij objektivi është edhe praktika profesionale pjesë e planit mësimor e shtrirë në dy vite mësimore dhe me një vëmendje të veçantë në TBU.</p> <p>Stafi akademik i TBU kryesisht punon në kompani, banka, institucione publike, etj. Kjo mundëson si sigurimin e një praktike eficiente por edhe sjelljen në auditor të njohurive të reja nga tregu, informacion apo mundësi</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>punësimi, etj.(Aneksi 17 dhe Aneksi 29)</p> <p>Edhe zyra e Alumni është në funksion të punësimit të suksesshëm dhe avancimit në karrierë. TBU ka marrëdhënie bashkepunimi me rreth 20 kompani dhe banka vendase dhe të huaja si dhe me shkolla të huaja nëpërmjet projektit ERASMUS. (Aneksi 34 dhe Aneksi shtese 03)</p> <p>TBU ka aplikuar leksione të hapura, vizita studimore, projekte të përbashkëta me aktorët e tregut, duke impaktuar në përsosjen e strategjisë së zhvillimit. Praktika mësimore e parashikuar në program shtrihet gjatë dy viteve të studimit pasi pjesa më e madhe e studentëve janë të punësuar.</p> <p>Zyra për Ç’ështëje Studentore dhe e Karrierës e TBU funksion normalisht për studentët e papunësuar, ajo komunikon me bizneset, konsulton studentët me mundësitë e punësimit që gjatë periudhës së studimeve. Punësimi i studentëve të këtij programi është në nivele të larta.</p> <p><i>Aneksi 7_Rreg_progr_stud_Mp_AB i Avancuar, Neni 5. Aneksi 47_Te dhena nga faqja zyrtare ëeb, Linku 7 dhe 8. Aneksi 29 Te dhena tabelore permbledhese per punesimin real te studenteve, Tabela 23.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimit të studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Ndonëse programi ka individualitetin e tij dhe i drejtohet një segmenti të caktuar, në TBU nuk gjetëm argumenta dhe programe të ngjashme në rajon apo më gjërë që sidoqoftë janë një orientim dhe motivim për përsosje e ndryshime. Për më tepër që rajoni ka karakteristika të ngjashme në aspektin e kërkesave të tregut, natyrën dhe nivelin e punësimit.</p> <p>GVJ vlerëson përfshirjen e TBU në programin e ERASMUS. Mobiliteti semestral i studentëve dy vitet e fundit, eksperiencia e fituar nga mobiliteti i stafit akademik, etj janë reflektuar në rishikimin e programeve, syllabluseve dhe literaturës</p> <p>Krahasueshmeria me kurrikula ne vendet e rajonit dhe BE sjell dobi dhe vlerë të shtuar për programet, aftësimin e studentëve për tregun lokal dhe atë ndërkombëtar.</p> <p><i>GVJ mbështetur në praktikën e gjetur në institucion, sugjeron se programi ka vend për rishikime duke u krahasuar me programe të ngjashme profesionale në tregun lokal, dhe në tregje gjeografikisht afër me shtetin tonë, si në Ballkan dhe BE, për të rritur konkurrueshmërinë e studentëve. Kjo si në drejtim të lëndëve që përmban, literaturës, elementët e ç’do lënde, mënyra e zhvillimit, etj.</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe</p>	<p>Ky program studimi është hartuar bazuar në legjislacionin shqiptar i cili është në përputhje me legjislacionin dhe direktivat e BE si dhe në përputhje me kërkesat e Bolonjës.</p> <p>Duke qënë nje program Master Profesional, mbështetur edhe në literaturën e rekomanduar në syllabluse dhe nga vizita edhe në bibliotekë, <i>gjykojmë se ka vend për shfrytëzim më intensiv të literaturës së huaj, që mund të aksesohet lirisht në TBU për shkak të disponibilitetit online që TBU u ka</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




praktikat e mira të vendeve evropiane.	<i>mundësuar studenteve.</i>			
<p>Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Sipas planit mësimor të programit të studimit parashikohet “praktika profesionale” me 6 kredite në përputhje të kërkesat e ligjit. Këtë detyrim studentët e plotësojnë duke kryer praktikën në institucionet ku ata aktualisht punojnë ose në institucione të tjera për të cilat institucioni ofron mundësi, ose sipas mundësive që ata privatisht disponojnë. Veçori e TBU është shtrirja e praktikës gjatë gjithë vitit mbi bazë javore.</p> <p>Praktika zhvillohet mbi bazën e një programi e udhëzimesh të caktuara që GVJ i gjeti në institucion, sipas një shpërndarjeje të caktuar midis pedagogëve dhe në fund të vitit akademik, realizohet edhe mbrojtja e saj.</p> <p>TBU ka avantazhin se thuajse të gjithë studentët e programit janë të punësuar. Sipas TBU 97% e studentëve të programit, por jo të gjithë janë në profilet që u mundësojnë praktikë profesionale sipas programit, gjë që është mundësuar në biznese të përshtatshme për programin e praktikës dhe u mundëson studentëve në të ardhmen një sistemim në punë. Sipas RVB, TBU ofron edhe plane mësimore individuale.</p> <p><i>Aneksi 29 Te dhena tabelore permbledhese per punesimin real te studenteve.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>Programi ofrohet në gjuhën shqipe përgjatë gjithë kohës së funksionimit të tij. Kështu theksohet edhe në rregulloren e programit.</p> <p>Duke e respektuar këtë kërkesë, GVJ, konstaton se në syllabuset e paraqitura mbi 90 % e literaturës për çdo temë dhe në tërësi për lëndën është në anglisht, gjë që kontraston disi me mënyrën e zhvillimit të lëndës. Ky fakt dhe perberja e stafit mundësojnë që në kuadrin e rishikimit të programeve të mundësohet edhe ofrimi i lendeve të caktuara apo edhe i nonje programi në gjuhë të huaj, si opsion i rritjes së cilësise se shërbimeve të TBU</p>			
<p>Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimin të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>	<p>Programi aktual është relativisht i ri, pra është ende herët të matet impakti dhe reagimi i tregut. Sidoqoftë TBU, ka stafin, strukturat e nevojshme dhe informacionin e tregut, mbi cilësinë e të diplomuarve dhe të programeve, me synim të bëjë modifikimet dhe përmirësimet e nevojshme.</p> <p><i>Në radhë të parë duhen rishikuar syllabuset, të mos jenë të njëta për nivelin bachelor dhe master siç u konstatua në lëndët manaxhimi strategjik, menaxhimi sistemeve të informacionit, vlerësimi i projekteve, qeverisja e korporatës, biznesi ndërkombëtar, manaxhimi strategjik, menaxhimi operacioneve, menaxhimi i cilësisë, menaxhimi i marrëdhënieve me klientin, marketingu ndërkombëtar, etj.</i></p> <p><i>Kjo për faktin, se pavarësisht rolit të lektorit në auditor për të bërë diferencën, shpërqëndrohet fokusi i studentit në çështjet, literaturën, detyrimet vjetore, etj.</i></p> <p><i>Për këtë arsye ndoshta duhet riparë nëse duhet të diferencohet roli i dy programeve në aspektin kurrikular dhe në tregun tek i cili ofrohet.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	




Standardi I.4	
Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>GVJ konstatoi se TBU ka burime njerëzore në fushën akademike në përshatje me qëllimin kryesor të tij. Stafi i Fakultetit është me përvojë dhe i kualifikuar (pjesa me e madhe), në fushat specifike që mbulojnë këtë program studimi. Nga shqyrtimi i dokumentave dhe vizita në Zyrën e Burimeve Njerëzore, sikurse dhe në takimet me stafin u vu re që peshë të ndjeshme në program zënë pedagogët e jashtëm dhe ata të ftuar, specialist të fushës por të punësuar në institucione të tjera. Madje është ndjekur praktika e mbulimit me module dhe bashkelektorimit në mjaft lëndë. Rekrutimi i stafit të ri bëhet sipas kriterëve të mirëpërcaktuara dhe akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>Sipas RVB dhe konstatimit gjatë vizitës në institucion TBU, ka mbuluar pjesën më të madhe të orëve mësimore, me staf akademik me kohë të pjesëshme. Praktikohet zhvillimi i lëndëve me ekip, dhe numuri i vogël i studentëve, bën që ngarkesa e pedagogëve të jetë e moderuar në orët në auditor por edhe në elementët e tjerë të ngarkesës.</p> <p>Sipas ankesit S.3 për vitin 2019-2020, programin e kanë ndjekur në total 30 studentë në të tre profilet, me një staf të brendshëm 13 vetë. Ngarkesa mësimore gjithësej në të gjitha programet varion për PAE nga 60 deri 210 orë ndërsa në këtë program sipas planit mësimor 60 orë gjithësej, ndahet në një deri tre bashkelektorë me jo më shumë se 30 orë për një lektor.</p> <p>Për më tepër TBU ka nënshkruar një marrëveshje me MARS, datë 5 nëntor 2018 dhe për specifikat e programeve që ofron lejohet që raportet midis pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm (PAE/PAK) të jenë në favor të atyre të jashtëm numerikisht por edhe për ngarkesën totale në auditor.</p> <p><i>Anekset 23, 24, 25</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse është Fakulteti i Administrim Biznesit, njësia bazë përgjegjëse është Departamenti i Menaxhimit. Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Menaxhimit.</p> <p>Në frymën e trajtimit në standartin 1.3 kriteri 3, <i>përsa i përket profilit e drejtë biznesi gjykojmë se ai mund të ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë dhe Departamenti i Menaxhim në këtë rast mund të jenë departament mbështetëse. Natyrisht kjo kërkon edhe ripozicionim të lëndëve bazë, karakterizuese e formuese të këtij profile.</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve</p>	<p>GVJ konstatoi se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit, si njësia bazë dhe përgjegjëse për programin e studimit dhe profilet përkatëse, <i>përshtatuar profilin e drejtë biznesi</i>, si edhe në përputhje të direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e europiane.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.									
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	TBU nuk ofron programe të ciklit të dytë ‘Master Profesional’ në ndonjë drejtim specifik jashtë profilit të institucionit.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Përveç drejtuesit të Departamentit i cili ka një rol kryesor në koordinimin e programit, TBU ka në strukturën e tij edhe koordinatore. Gjatë vizitës në institucion dhe në RVB, referohet se njëra bazë dhe njësitë përgjegjëse kanë analizuar periodikisht performancën e programit, të punës së stafit, matjen e performancës së mësimdhënies dhe mësimnxënies, të cilat janë bërë pjesë edhe e raportit vjetor të realizimit të programit, roli dhe funksioni i të cilit është kryesisht administrativ. <i>Në raportin pjesë e DVV (aneksi 38) relatohet për ndryshimin e kurrikulave sipas përvojës së Stafordshire University, por nuk gjetëm një analizë specifike të performancës së lëndëve apo pedagogëve, mbështetur në gjetjet e vetë pedagogëve, të departamentit, të gjetjeve apo anketimeve të studentëve, etj. Po ashtu, do të sugjerim një pasqyrë më analitike se në cilët element të programit, të syllabluseve etj është ndërhyrë në programin e vitit 2018-2019 mbështetur në përvojën e Stafordshire University apo edhe të sugjerimeve të tjera ndërkombëtar të kurrikulave .</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Nga shqyrtimi i dokumentave të dorëzuara nga IAL dhe takimeve me studentët si dhe stafin, GVJ konstatoi se TBU ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe me organizata biznesi, të cilat ndikojnë në realizimin e objektivave të programit të studimit. Sipas aneksit 34, TBU mban marrëveshje aktive me 41 biznese dhe institucione apo universitete, brenda dhe jashtë vendit. TBU bashkëpunon me 120 organizata biznesi, për praktikat mësimore, etj. TBU ka marrë pjesë rregullisht me kontribute dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore organizuar në shkolla apo institucione të tjera.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>GVJ konstatoi se në planin mësimor të këtij program studimi praktika profesionale zë një vend të rëndësishëm, ajo shoqërohet me 6 kredite (ECTS), dhe ka qëllim që studenti të zbatojë njohuritë teorike në praktikë, të ketë kontakte me tregun e punës etj. TBU ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe me organizata biznesi të cilat shfrytëzohen për praktikat profesionale të studentëve. Konstatohet se ndjekja dhe realizimi i praktikave të studentëve është i organizuar dhe funksional. Ky bashkëpunim realizohet në kryerjen e praktikave profesionale nga studentët, ofrimin e shërbimeve kërkimore dhe të konsulencës nga TBU, punësimi i studentëve, etj.</p> <p><i>Aneksi 34 Mareveshje bashkëpunimi me institucione te ndryshme</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>Bashkëpunimi ndërmjet TBU dhe bizneseve për bërjen të mundur realizimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij programi studimi, bëhet nëpërmjet marrëveshjeve por edhe me anë të kërkesave të veçanta. U konstatua se institucioni/biznesi ku studentët kryejnë praktikën është i lidhur me fushën e studimit. Në peshën dërrmuese studentët janë të punësuar kryesisht në profile që ofrojnë mundësi praktike.</p> <p><i>Aneksi 34 Mareveshje bashkëpunimi me institucione te ndryshme, Aneksi 32 Tabele permbledhese me institucionet bashkëpunuese, Aneksi 47 linku 9.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Institucioni nuk ofron trajnime profesionale të mirëfillta. Sidoqoftë ky fakt është zbutur me kurse afatshkurtra të ofruara në bashkëpunim në ekspertë të fushave specifike te grupit Balfin e biznese te tjera, për studentët e diplomuar ndër vite, mbas diplomimit të tyre.</p> <p>Po ashtu jane organizuar takime, konsulta, aktivitete ku jane ftuar ish studente te TBU. Vete evoluimi e konsolidimi i programeve do sjelle nevojën e organizimit te trainimeve profesionale ne te ardhmen.</p> <p>TBU mban kontakte me të diplomuarit, i fton të jenë pjesë e seminareve speciale, ëorkshopeve, diskutimeve nga lektorë të ndryshëm të ftuar.</p> <p><i>Aneksi 47 linku 1.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni kryen analiza periodike të përfitimeve nga marrëveshjet dhe i përfshin këto analiza në raportet e departamentit, fakultetit dhe zyrës së Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Në kuadër të marrëveshjes me Institutin për Kërkime dhe Zhvillim Rajonal, është organizuar konferenca XI Shkencore Ndërkombëtare. Në kuadër të marrëveshjes me Qëndrën Kërkimore dhe Shkencore, TBU vazhdon bashkëpunim me Universitetin La Sapienza, Romë. TBU, në kuadër të një marrëveshje të lidhur midis saj dhe “International Institute for Private, Commercial and Competition Law” (Austri), më datë 05/04/2018, bashkëpunon për botimin e revistës “Balkan Journal of Interdisciplinary Research” me kod iv. ISSN 2410-759X, e cila botohet në Austri 3 herë në vit (Janar, Maj dhe Shtator). Njësitë bazë të të dy Fakulteteve të TBU, Fakultetit Administrim Biznesi dhe Fakultetit i Drejtësisë, i kanë propozuar Qendrës për Kërkime Ekonomike dhe Juridike tematika të caktuara për konferencën që organizohet nga “International Institute for Private, Commercial and Competition Law” në bashkëpunim me TBU.</p> <p><i>Aneksi 47 Te dhena nga faqja zyrtare ëeb, Link 7.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit është riorganizuar sipas vendimit të Senatit Nr.33, datë 17.06.2016. <i>Institucioni i riorganizon këto programe në Master Profesional Administrim Biznesi me profil; Finance -Kontabilitet, me 120 ect, Master Profesional Administrim Biznesi me profil Menaxhim me 120 ect dhe 60 ect dhe Master Profesional Administrim Biznesi me profil E Drejte Biznesi me 120 ect.</i> Për hartimin e planit mësimor janë respektuar kërkesat e VKM 41 datë 24.01.2018, “Për elementët e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”. Sipas nenit 5 në aneksin 7 të rregullores së programit të studimit, miratuar nga senati akademik i TBU, janë parashikuar gjithsejt 120 kredite të ndara në: 6 kredite disiplina e formimit të përgjithshëm (A); 42 kredite disiplina karakterizuese (B); 36 kredite disiplina ndërdisiplinore, integruese dhe profilizuese (C); 12 kredite disiplina plotësuese (D) dhe 24 detyrime përmbyllëse (E).
Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Ky program studimi me profilet përkatëse synon në përgatitjen e profesionistëve në fushën e menaxhimit, kontabilitet financës dhe të drejtës së biznesit të aftë të operojnë në sektorët përkatës të tregut, në zyra konsulente, në biznese private apo institucione financiare bankare dhe në sektorin publik. <i>Aneksi 5 Rregullore e programit të studimit MPABA</i>
Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Programi i studimit, përfshin module që kanë si qëllim jo vetëm njohjen me teorinë, por aplikimin e tyre në praktikë, si lëndë të avancuara, ku edhe theksohen njohuritë e avancuara në secilën nga këto lëndë. <i>Përfshirja në program e një numri të konsiderueshëm lëndësh të avancuara, i japin programit më shumë pamjen e një programi studimi Master Shkencor se sa Profesional.</i> <i>Po t'i referohemi syllabluseve të lëndëve, praktikës së mësimdhënies, të kontrollit të dijeve, detyrave të kursit, punimeve në grup, etj që mbështeten në sjelljen në auditor të eksperiencave, punëve praktike, situatave konkrete të biznesit etj të pranishme në çdo lëndë, filozofia e funksionimit të këtij programi është aftësimi teoriko-praktik dhe kompetenca profesionale në</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<i>fushat respektive dhe jo thellimi akademik.</i> <i>Aneksi 19 Syllabuset e Lendeve MP AB.</i> <i>Aneksi 19.1 Syllabuset e Lendeve MP AB.</i>			
Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programet janë hartuar e përmirësuar nga viti në vit në mënyrë të tillë që të zhvillojnë njohuri në fusha kryesore të menaxhimit, financës, kontabilitetit, të së drejtës, duke harmonizuar formimin teorik e akademik me atë të mirëfilltë praktik e profesional. Në analizën e ecurisë së programit dhe përsosjet e bëra për vitin 2019-2020 në kurrikulat t e lëndëve është synuar kjo gjë. <i>Aneksi 38 :Analizë e realizimit te objektivave të Programit te studimit të MPABA</i>			
Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Ky program studimi, përmban të gjitha elementët e struktues së programit, përcaktuara në VKM 41 datë 24.01.2018 që u trajtuan në kriterin 1 të këtij standarti.			
Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Ky program studimi dhe ofrohet nga Fakulteti i Administrim Biznesit si njësi kryesore, nga Departamenti i Menaxhimit si njësi bazë. Në funksion të kësaj ndarjeje janë caktuar edhe kordinatorët e programit. Programet kanë të caktuara veprimtaritë formuese, të grupuara modulet sipas kërkesave ligjore duke respektuar edhe raportet që përcakton VKM 41 datë 24.10.2018. Janë përcaktuar në mënyrë uniforme edhe 6 kredite për çdo lëndë pavarësisht klasifikimi dhe roli i saj në formimin e studentit. <i>GVI vlerëson këtë punë ndërkohe ashtu siç edhe u diskutua në takimin me pedagogët rekomandon diferencimin e krediteve sipas peshës dhe rëndësisë së lëndëve në formimin bazë, karakteritues, plotësues. Ndonse kjo vështirëson disi planifikimin dhe shtrirjen semestrale të lëndëve dhe orëve mësimore, gjykojmë se është e zgjidhshme në aspektin menaxherial të procesit mësimor, por respekton kriterin shkencor dhe kontributiv të ç' do lënde në program.</i> <i>Aneksi 14.1 Plani mësimor i programit MPABA</i>			
Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	Kordinatorët e programit janë në kontakt të drejtpërdrejtë me përgjegjësën e Departamentit në lidhje me ecurinë e programit në aspektin e problematikave që lindin. Programet parashikojnë ngarkesën në auditor, jashtë tij duke respektuar kërkesat e VKM 41 datë 24.01.2018. Kjo është sanksionuar edhe në rregulloren e programit, duke përcaktuar disiplinat karakterizuese, me zgjedhje, praktikat mësimore. <i>Aneksi 7_Rreg_progr_stud_Mp_AB i Avancuar.</i> <i>Aneksi 14.1_Plani mesimor MP AB 19-20.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programi MPABA me profilet e tij ofrohet nga Departamenti i Manaxhimit dhe mbështetet nga tre departamentet në strukturën e Fakultetit të Administrim Biznesit.</p> <p>Ky organizim reflektohet në strukturën e fakultetit, në Statutin e TBU miratuar me Urdhërin e MASR nr 41 datë 20.09.2017.</p> <p>Nga dekani i fakultetit janë propozuar dhe nga Rektori janë emëruar në përputhje me kërkesat e statutit të TBU neni 18, tre përgjegjësit e departamenteve. Nga dekani i Fakultetit të Administrim Biznesit është bërë shpërndarja e programeve sipas njësive bazë, janë emëruar tre kordinatorë dhe janë përcaktuar në mënyrë të hollësishme detyrat e tyre me vendimin nr.prot 12 datë 30.05.2019 . Ky program i është ngarkuar Fakultetit të Administrim Biznesit dhe njëkohësisht për këtë program edhe kordinatori është përgjegjësi i Departamentit. Në vendimin e sipërcituar trajtohen edhe detyrat e kordinatorëve që përkohë dukshëm edhe me ato të departamenteve lidhur me programin, shpërndarjen e ngarkesës, infrastrukturën, nevojën e rishikimit të syllabluseve nevojat për kapacitete akademike, kordinatorët si pjesë e sistemit të brëndshëm të cilësisë, ngarkohen të bëjnë rishikimin e shpërndarjes së krediteve, të elementëve përbërës të disiplinave dhe ndarjen e krediteve ndërmjet tyre (leksione, seminare, detyra, projekte, laboratore, etj) rishikimin e programeve dhe strukturës së planit mësimor. Nga plani mësimor dhe shpërndarja e krediteve u konstatuan:</p> <p><i>Shpërndarja e krediteve është bërë në mënyrë uniforme nga 6 për ç' do lëndë (shih komentin në kriterin 6 të standartit II:1 dhe nuk është bërë ndarja e krediteve sipas elementëve të cituar në vendimin e dekanit, kjo për ta mobilizuar studentin në përmbushjen cilësore dhe në kohë të të gjithë elementëve të procesit mësimor, leksione, seminare, detyra kursi)</i></p> <p><i>Aneksi 2 TBU Statuti</i> <i>Aneksi 6: Rregullore e njësisë bazë,</i> <i>Aneksi 7: Rregullore e programit MPABA</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Njësitë bazë të Fakultetit të Administrim Biznesit dhe vetë njësia kryesore, fakulteti, janë ndërtuar në përputhje me detyrimet ligjore, respektojnë dhe tejkalojnë marëveshjen e datës 5 nëntor 2018 nënshkruar nga TBU me MASR 'për përcaktimin e numrit të personelit akademik, me kohë të plotë, në njësitë bazë'.</p> <p>TBU konsiderohet Kolegj Universitar dhe duke respektuar nenin 17, pika 7 të ligjit 80/ 2015, nuk detyrohet të përmbushë pikën 4 të nenit 25 të ligjit të mësipërm.</p> <p>Referuar dokumentit (Aneks 23. Të dhëna tabelore personel akademik njesia kryesore dhe njesia përgjegjese), Fakulteti i Administrim Biznesit në vitin akademik 2019-2020 përbëhet nga:</p> <p>- Departamenti i Kontabilitet-Financës, i cili ka 6 PAE, nga ku 3</p>




	<p>grada/tituj dhe 7 PAK;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i Menaxhimit, i cili ka 10 PAE, nga ku 4 me tituj/grada dhe 10 PAK; - Departamenti i Lëndëve të përgjithshme , i cili ka 13 PAE, nga ku 3 me grada/tituj dhe 3 PAK; <p><i>Aneksi shtese 06_Mareveshja MASR_TBU_percaktimi_personaleti_akademik.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Referuar aneksit “<i>Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB</i>”, konstatohet se departamenti i menaxhimit si njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi në vitin akademik 2018-2019 përbëhet prej të cilëve 2 Prof as; 3 PhD; 2 Msc dhe 14 PAK, prej të cilëve 1 Prof; 1 Prof As; 3 PhD; 9 Msc. Ndërsa për vitin akademik 2019-2020 departamenti i menaxhimit përbëhet nga 10 PAE, prej të cilëve 1 Prof; 2 Prof As; 1 PhD; 6 Msc dhe 10 PAK prej të cilëve 1 Prof As; 3 PhD; 6 Msc.</p> <p>Duhet theksuar që pedagogët e këtij programi janë të angazhuar edhe në programe të tjera apo edhe nivelin bachelor, kjo për shkak të mundësive të kufizuara me burime njerëzore të një institucioni si TBU, me një numur studentësh në total rreth 500, në të dy nivelet.</p> <p>Në funksion të qëllimit të programit, përgatitjen në një kohë relativisht të shkurtër të profesionistëve në administrim biznesi, kontabilitet, finance, të drejtë biznesi, përpunohen ç’do vit syllabuset duke synuar rritjen e njohurive që ofrohen dhe shkallën e transmetimit dhe përvetësimit të tyre.</p> <p><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lendeve MP AB. Aneksi 19.1 Syllabuset e Lendeve MP AB.</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Shih komentet në kriterin 2</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Programi MPAAB ofrohet nga Departamenti Manaxhimit si departament përgjegjës dhe me departamente mbështetëse Departamentin Kontabilitet-Financë dhe Departamentin e Lëndëve të Përgjithshme. Departamentet respektojnë detyrimet ligjore që rrjedhin nga marrëveshja që TBU ka nënshkruar me MASR, përsa i përket numrit të tyre, strukture me tituj e grada, ngarkesës mësimore, numurit të studentëve për ç’do pedagog, si dhe realizimin e praktikave mësimore. I gjithë stafi i departamentit, angazhohen në ndjekjen e praktikave mësimore, që për këtë program, shpërndahet gjatë dy viteve mësimore dhe realizohet kryesisht në vendet ku studentët janë të punësuar. Sipas një programi të caktuar, ndjekjeje sistematike nga stafi.</p> <p><i>Aneksi shtese 05_Vendim percaktimi drejtuesve praktikës mesimore 2018-2019. Aneksi shtese 06_Mareveshja MASR_TBU_percaktimi_personaleti_akademik.</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për</p>	<p>Sipas RVB dhe vizitës së GVJ në TBU, për programin MPAAB, si njësi</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>bazë përgjegjëse është caktuar Departamenti Menaxhimit, duke u emëruar edhe si koordinator përgjegjës i Departamentit. (Shih trajtimin në kriterin 1 të këtij standarti). Janë përcaktuar edhe detyrat për koordinimin e punës me njësitë e tjera bazë në nivel fakulteti. Në fillim të ç'do viti janë përcaktuar me vendim dekanit personat përgjegjës për praktikën mësimore</p> <p><i>Aneksi shtesë 05: Vendim i dekanit për mbikqyrësit e praktikës së programit.</i></p> <p><i>Aneksi 36_Vendim per emerimin e koordinatorëve te programeve_AB.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>	<p>Kordinatori i programit është përgjegjës i departamentit ai ndjek në mënyrë periodike ecurinë e programit, mbështetjen me staf akademik, realizimin e komponentëve të programit nga ç'do pedagog duke respektuar lirinë akademike. Në vendimin nr 12 datë 30.05.2019 të dekanit të Fakultetit të Administrim Biznesit për emërimin e koordinatorëve të programeve të studimit dhe shpërndarjen e programeve sipas departamenteve, ç'do kordinator, ndër të tjera, ngarkohet të raportojë ecurinë e programit. Duke bërë analizë në departament vihen në dukje arritjet, ndryshimet në strukturën e lëndëve, zëvendësimi i lëndëve, përmirësimet në syllabluse, etj.</p> <p>Në <i>aneksin 24 tabela 12</i>, jepen planet mësimore të programit të studimit, nga momenti i riorganizimit nga 90 ECTS në 120 ECTS për vitet 2016-2017, 2017-2018, 2018-2019 dhe 2019-2020. Këto plane janë evoluim i riorganizimit te programeve nga 90 në 120 kredite</p> <p><i>Aneksi 36 Mbi emrimin e kordinatorëve të programeve të studimit</i></p> <p><i>Aneksi 38_Analize e realizimit te objektivave Programi Studimit MP Ab_18-19.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.3</p> <p>Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe nga dokumentacioni i depozituar në sistemin AMS, GVJ konstatoi se për këtë program studimi njësia kryesore dhe ajo bazë disponojnë dokumentacionin lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit ku përfshihen: statuti TBU, rregullorja e Fakultetit dhe Departamentit, rregullorja e programit, plani strategjik për zhvillimin e programit, plani mësimor, syllabluset e lëndëve etj.</p> <p><i>Aneksi 14 Dosja e plote e programit te studimit me elementet perberes te tij.</i></p> <p><i>Aneksi 14.1_Plani mesimor MP AB 19-20.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese,</p>	<p>Programi i studimit MPABA, duke iu referuar atij të vitit 2019-2020 ka respektuar në strukture kërkesat e VKM 41 datë 24.01.2018. Mbi këtë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>bazë rregullorja e programit përmban veprimtaritë formuese të grupuar sipas kategorive të ligjit dhe me ngarkesën. Më poshtë jepen grupimi i lëndëve, kërkesat e VKM së sipërcituar dhe realizimi i tyre sipas programit mësimor për 2019-2020, si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Lëndë baze: 5-10 % (6-12 ECTS) realizuar 6 ECTS 2. Lëndë karakterizuese: 30-40% (36-48 ECTS) realizuar 42 ECTS 3. Lëndë ndërdisiplinore, integruese profilizuese 20-30% (26-36 ECTS): realizuar 36 ECTS 4. Lëndë plotësuese: 10%; 12 ECTS realizuar ECTS 5. Detyrime permbylëse: 10-20%, 12-24 ECTS realizuar 24 ECTS. <p><i>Aneksi 7_Rreg_progr_stud_Mp_AB i Avancuar.</i></p>																					
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Ky programi studimi është riorganizuar para 4 vitesh mbi bazën e programit Master 90 Ects, trajtuar në pjesën përshkruese të këtij RVJ. Sipas rregullores dhe planit mësimor të vitit 2019-2020 numri i lëndëve është si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="587 808 1273 1193"> <thead> <tr> <th></th> <th>Rregullorja programit</th> <th>Plani 2019-2020</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>a. Lëndë bazë:</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>b. lëndë karakterizuese</td> <td>11</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>c. lëndë ndërdisiplinore, profilizuese, me zgjedhje,</td> <td>10</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>d. Lëndë plotësuese</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>e. <u>Detyrime përmblylëse</u></td> <td>1</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>24</td> <td>18</td> </tr> </tbody> </table> <p>Të gjitha lëndët janë të vlerësuara me ECTS sipas ligjit dhe në përfundim të studimeve studenti përfiton 120 ECTS.</p> <p>Nga numri i lëndëve potencialisht për t'u zhvilluar në vitin akademik 2019-2020 janë piketuar 15 lëndë, praktika mësimore dhe detyrimet përmblylëse mbrojtje diplome ose provim formimi.</p> <p>Duke analizuar syllabluset e paraqitura në Aneksin 19, konstatohet se janë paraqitur syllabluset e 36 lëndëve, kur sipas rregullores së programit më sipër duke përfshirë edhe lëndët me zgjedhje janë 24 lëndë nga të cilat zbatohen në vitin aktual, 15 lëndë pa përfshirë praktikën profesionale dhe detyrimet përmblylëse.</p> <p>Nga 36 lëndët e paraqitura 13 i përkasin biznesit, 3 marketingut (ndonse ndarja midis këtyre dy fushave është e diskutueshme), 4 lëndë kontabiliteti, 7 lëndë financiare, 1 lëndë informatike.</p> <p><i>Pra shohim një bollëk lëndësh në të drejtën, mjaftueshëm lëndë në biznes, ku lënda bazë nuk është e dubluar me një lëndë bazë tjetër siç mund të jenë ekonomiksi, metodat e kërkimit, apo njohuri mbi ekonometrinë, për më tepër që mbi 60 përqind e lëndëve, konceptin bazë të interpretimit në auditor e kanë detyra kursi, projekte në grup, etj, nuk janë të pranishme lëndë shkrimi akademik, etj..</i></p>		Rregullorja programit	Plani 2019-2020	a. Lëndë bazë:	1	1	b. lëndë karakterizuese	11	6	c. lëndë ndërdisiplinore, profilizuese, me zgjedhje,	10	8	d. Lëndë plotësuese	1	1	e. <u>Detyrime përmblylëse</u>	1	2	Gjithsej	24	18
	Rregullorja programit	Plani 2019-2020																				
a. Lëndë bazë:	1	1																				
b. lëndë karakterizuese	11	6																				
c. lëndë ndërdisiplinore, profilizuese, me zgjedhje,	10	8																				
d. Lëndë plotësuese	1	1																				
e. <u>Detyrime përmblylëse</u>	1	2																				
Gjithsej	24	18																				




	<p><i>GVJ rekomandon reduktimin e disa nga lëndëve të paraqitura në syllabluse, koncentrimin e rishikimin në këndvështrimin e mësipërm të klasifikimit të lëndëve, prezencën e lëndëve me zgjedhje në planin mësimor.</i></p> <p><i>Aneksi 7_Rreg_progr_stud_Mp_AB i Avancuar.</i> <i>Aneksi 14.1_Plani mesimor MP AB 19-20.</i> <i>Aneksi 19 Syllabuset e Lendeve MP AB.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Referuar planit mësimor, vizitës në institucion, diskutimit në takimin me pedagogët dhe përgjegjësit e departamenteve, u konstatua se ky program studimi, përmban elementët që përbëjnë strukturën e programit sipas ligjit, si struktura e krediteve, orët në auditor, orët jashtë auditorit, studimin e pavarur, sipas viteve dhe semestrave, frekuentimin dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve.</p> <p><i>Skema e vlerësimit nuk është e njëjtë në të gjitha lëndët, në mjaft lëndë mënyra e kontrollit të dijeve dhe vlerësimit dominohet nga detyrat apo punët e kursit dhe në disa të tjera janë respektuar kërkesat e ligjit si 30-40 përqind vlerësimi vjetor (frekuentim, detyra kursi, test i ndrmjetëm dhe 60-70 përqind testi përfundimtar). Në syllabuset e paraqitura vihen re lëndë me 60% detyra dhe frekuentim dhe 40 % testi përfundimtar.</i></p> <p><i>Në kushtet kur kjo frymë është në të gjitha lëndët, studentët janë të punësuar, mundësitë e gjetjes së informacionit në Shqipëri janë të mangëta e me probleme, për 4-5 lëndë në semestër i duhet të përgatisë rreth 7-8 punime e detyra, pa përjashtuar edhe testet e ndërmjetme, shfrytëzimi i informacionit në gjuhë të huaj me gjithë aksesin që ka ç' do student, rezulton në nivele modeste, gjykojmë se fryma bashkëkohore e synuar nga programi, kompromentohet e ekzagjerohet nga punimet vjetore dhe çenohet formimi bazë konceptual i studentit si dhe krijon subjektivizëm në vlerësimin e tij. GVJ rekomandon që ky konstatim të jetë objekt diskutimi dhe përsosjeje në departamentet respektive dhe në mënyrë të përmbledhur për programin nga njësia kryesore me synim përafrimin e elementëve të syllabuseve në frymën e kërkesave të VKM, duke respektuar edhe lirinë akademike.</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Ky program studimi ka rregulloren e tij ku përfshihet i gjithë informacioni i nevojshëm për studentët në lidhje me pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve.</p> <p><i>Aneksi 5_Rregullore e Institucionit_TBU.</i> <i>Aneksi 7_Rreg_progr_stud_Mp_AB i Avancuar.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikatat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Ky program studimi përmban të gjithë informacionin lëndor dhe praktikatat që lidhen me të si dhe të gjithë elementët formues të programit sipas kërkesave të ligjit dhe rregulloreve të brendshme të Fakultetit.</p> <p>GVJ nga shqyrtimi i syllabuseve, konstaton se në këto syllabuse ka informacion për objektivat, për literaturën, për format e organizimit, mënyrën e vlerësimit etj. GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion seminar.</p> <p><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lendeve MP AB.</i></p>

	<i>Aneksi 19.1 Syllabuset e Lendeve MP AB.</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Sipas analizës vjetore të programit, janë bërë ndryshime lëndësh për vitin 2019-2020 në krahasim me një vit më parë dhe përmirësime në syllabuse në lëndë të veçanta, bazuar edhe në vërtetimet e ecurisë së procesit mësimor, anketimet e studentëve, analizat në departamente dhe reflektimet e vetë lektorëve që në disa lëndë janë gruo lektorësh. <i>Aneksi 38(Raport mbi analizën e realizimit të objektivave të programit MPAAB për vitin 2018-2019)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Sipas informacionit në Aneksin 14.1 procesi mësimor realizohet në dy vite akademike, me 120 kredite, me 3000 orë në total nga të cilat 840 orë në auditor, 900 orë praktikë, 1260 orë studim individual. Viti akademik është 30 javë në dy semestra, 4 javë sezon provimesh, 16 orë ngarkesa javore në mësim.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive kryesisht mundësojnë thellimin e njohurive respektivisht në fushën e menaxhimit, kontabilitet- financës dhe të së drejtës së biznesit. Por në lidhje me përmbajtjen e tyre vërehen prirje të lëndëve, ngjeshje të koncepteve dhe përdorim i të njëjtit program dhe i së njëjtës literature, dhe të të njëjtave kërkesa, objektiva mënyrë kontrolli dijes si në sistemin bachelor. Ky konstatim mbështetet në faktin se në mjaft lëndë syllabuset janë të njëjta për të dy sistemet ç'ka megjithë menaxhimin në auditor të lektorit apo seminaristit për të bërë diferencat krijon konfuzion dhe subjektivizëm në elementët e mësimdhënies dhe mësimnxënies. (shih komentin e bërë më parë në këtë RVJ standarti 1.3 kriteri 8). Prezenca e një sërë detyra kursi në ç'do lëndë, forma e kontrollit të dijeve mbështetur kryesisht në këta elementë, fakti i të qenit të punësuar të thujse të të gjithë studentëve të programit, shtrirja e praktikës profesionale në dy vjet dhe ndjekja e saj me program të miratuar dhe udhëheqës praktike, prezantimi i raportit të praktikës para diplomimit, pikprerjet e lëndëve që janë në funksion të një formimi tërësor të studentit, kanë mundësuar një formim teoriko praktik të përshtatshëm për të siguruar një punësim stabil apo edhe avancim në karrierë. <i>Aneksi 7_Rreg_progr_stud_Mp_AB i Avancuar.</i> <i>Aneksi 17. Studimi per tregun e punes, Janar 2020.</i> <i>Aneksi 41_Pyetesor stafi akademik.</i> <i>Aneksi 47_Te dhena nga faqja zyrtare ëeb, linku 9.</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Sipas planit mësimor, të këtij programi për vitin 2019-2020, është përcaktuar shpërndarja e lëndëve dhe moduleve ndër vite. Për profilin manaxhim ajo është: 4 lëndë në semestrin e parë duke patur fleksibilitet në zgjedhje të lëndës së katërt midis Menaxhim Operacionesh dhe Menaxhim Projekti, në varësi të faktit se cilën prej tyre kanë zhvilluar studentët në nivelin bachelor, 4 lëndë në semestrin e dytë, duke patur fleksibilitet në zgjedhjen e lëndës së katërt midis Vlerësim Projekti dhe Qeverisje Koorporatash për të njëjtën arsye si më sipër, 4 lëndë në semestrin e parë të vitit të dytë nga të cilat dy prej tyre implementohen në vijim të programit dhe në semestrin e katërt përmblyllës kanë dy lëndë me zgjedhje, praktikën profesionale, raportin e përvojës dhe temën e diplomës.</p> <p>Për profilin kontabilitet financë semestri i parë ka 4 lëndë nga të cilat 2 përzgjidhen nga studentët nga lista me tre lëndë Menaxhimi Riskut Financiar, E drejta fiskale dhe krahasuese dhe E drejta Bankare e Financiare, semestri dytë 4 lëndë, semestri tretë 4 lëndë, nga të cilat 3 lëndë të papërcaktuara në planin mësimor, kjo në varësi të lëndëve të zhvilluara më parë nga studentët dhe semestri katërt dy lëndë me zgjedhje, detyrimet përmblyllëse njëloj praktika profesionale, raporti përvojës profesionale, projekt menaxhimi përfundimtar dhe tema e diplomës.</p> <p>Për profilin e drejta e biznesit semestri i parë 4 lëndë nga të cilat 3 prej tyre përzgjidhen nga studentët nga një listë prej 4 lëndësh paraqitur në planin mësimor, E drejta fiskale dhe e krahasuar, E drejta bankare dhe financiare, E drejta civile dhe kontratat, E drejta e shoqërive tregtare, 4 lëndë në semestrin e dytë, 4 lëndë në semestrin e tretë nga të cilat 3 të papërcaktuara në planin mësimor në varësi të formimit paraardhës të studentit dhe në semestrin e katërt dy lëndë me zgjedhje, raporti praktikës profesionale, raporti përvojës profesionale, projekt menaxhimi përfundimtar dhe tema e diplomës.</p> <p>Plani mësimor si më sipër jep fleksibilitet të madh dhe hapsira për ç'do student në funksion të vendit të tij të punës dhe interesave të karrierës. Por duke patur parasysh numërin e ulët të studentëve në këtë program gjykojmë se shfrytëzimi si duhet i këtyre hapsirave e redukton numrin e studentëve në këto lëndë të papërcaktuara në program deri në 2-3 studentë për lëndë specifike gjë që gjykojmë se do ta kthente mësimdhënien kryesisht në një seancë konsultimi e rekomandimi, duke shmangur leksionet tradicionale, komunikimin ndërstudentor e punët e projekteve në grupe më të mëdha që është në filozofinë e këtij programi.</p> <p><i>Ndonëse në parim e vlerësojmë këtë mënyrë konceptimi, rekomandojmë reduktimin e këtij fleksibiliteti dhe fiksimit e lëndëve në planin mësimor që mundëson edhe departamentet dhe stafin për një përgatitje dhe ndjekje më cilësore të programit. Kjo është edhe në interes të studentëve sepse i krijon mundësi lëvizje dhe karriere më tej brenda vendit ku punojnë apo edhe të përafërta.</i></p> <p><i>Aneksi 14.1: Plani mesimor MPAAB 2018-2019</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt</p>	<p>Struktura e programit me të gjitha elementët që e shoqërojnë janë në përputhje me profilin e programit. <i>Në lidhje me programet e tjera ndërkombëtare GVJ mendon se përafërimi ndërkombëtar duhet të jetë në fillim gjeografik rajonal në Ballkan dhe Europë, gjë të cilën nuk e konfirmon në këtë rast.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




me programe të ngjashme ndërkombëtare.	<i>Aneks 38 Analizë e realizimit të objektivave të programit MPAAB 2018-2019</i>			
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja sipas veprimtarive formuese ndjek kërkesat ligjore. GVJ gjykon se larmia e madhe e lëndëve, mundësitë e fleksibilitetit të studentëve, prezenca e lartë e detyrimeve praktike, detyra e punë kursit, praktika profesionale, raportit përvojës dhe projekti menaxhimit, etj që janë sendëzuar edhe me kreditet përkatëse, ofrojnë mobilitetin, transferimin dhe punësimin e nevojshëm gjë që është materializuar në punësimin real të studentëve të këtij programi.			
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Syllabluset e lëndëve ndjekin procesin e përditësimit ç’do vit akademik, proces ky që nënvizohet në analizën e punës mësimore. GVJ në rishikim të dokumentacionit vëren se syllabluset janë hartuar me rubrikat përkatëse dhe literaturë të përditësuar thuajse në anglisht për ç’do temë të lëndës por edhe në fund të programit të saj, shoqëruar edhe me detyrimet, mënyrën e mësimdhënies, etj. Në bibliotekën online EBSCO për të cilën TBU ka akses pasi abonohet ç’do vit, gjënden materialet e rekomanduara.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.	GVJ gjykon nga përmbajtja e programeve të lëndëve se për këtë nivel studimi dhe për programin MPABA me profile, garantojnë përfitim të dijeve dhe formimin teorik dhe sidomos praktik të studentëve për të aftësuar përshtatjen e tyre me tregun dhe punësimin e tyre.			
Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Duke marrë parasysh edhe ato që kemi përmendur në kriterin 7 më sipër, GVJ gjykon se zbatimi me sukses i programit, duke respektuar fleksibilitetin e tij që ofron plani mësimor, por edhe mënyrën e interpretimit gjatë një semestri të plotë për lëndët formuese, karakterizuese, përmblylëse etj, ofron kompetenca dhe formim të thelluar profesional. <i>Aneksi 7 Rregullore e Programit MPAAB; Aneksi 14.1: Plani mësimor MPAAB</i>			
Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	GVJ gjykon se përmbajtja e programit e mundëson ecurinë e studentëve në studime të mëtejshme dhe avancim në karrierë në tregun e punës. Rekomandimet e dhëna më sipër për përsosjen e programeve dhe elementëve të tyre, në planifikim dhe realizim nga njëjësia bazë dhe ajo kryesore, rrisin mundësitë e punësimin dhe avancimin në karrierë në një treg pune që është sfidant dhe me kërkesa në rritje në aspektin profesional.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardevë të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>është: 13 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët 1 Prof; 4 Prof As; 3 PhD; 5 Msc dhe 5 personel akademik me kontratë (PAK) nga të cilët 2 PhD; 3 Msc.</p> <p>Përsa më sipër, personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në këtë program studimi nuk përmbush kërkesat ligjore në fuqi, më konkretisht pikës 6 të nenit 59 të ligjit 80/2015, ku thuhet se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie duhet të këtë të paktën kualifikimin e ciklit pasardhës.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Referuar tablës 12 (<i>Aneksi. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB</i>) stafi akademik me kohë të plotë mbulon 1080 orë ose 78% të ngarkesës së programit të studimit, ndërsa stafi akademik me kontratë mbulon 300 orë ose 22 % të ngarkesës së programit të studimit.</p> <p>Por të dhënat për orët mësimore në këtë tabelë për këtë program studimi janë më shumë se dyfishi i orëve mësimore të deklaruara në planin mësimor tabela 10, (<i>Aneksi_Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB</i>) për këtë program studimi.</p> <p>GVJ konstaton se ka paqartësi dhe parregullsi në orët mësimore të deklaruara që mbulohen nga stafi akademik.</p> <p><i>Aneksi 24 Të dhëna tabelore: Personeli akademik i programit;</i> <i>Aneksi 25 Të dhëna tabelore Ngarkesa e plote e stafit akademik</i> <i>Aneksi. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB, Tabelat: 6, 7, 8, 10.2 dhe 12.</i></p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i CV-ve të stafit si dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p> <p><i>Aneksi 20_CV_Stafi Akademik Programi Mp_AB.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas vizitës në institucion dhe marrëveshjeve në fuqi si dhe nga takimi me studentët, TBU ofron mundësinë për të udhëzuar studentët në praktikën e tyre profesionale. Duke qenë se një pjesë e studentëve janë të punësuar, në pjesën më të madhe institucioni ofron mbështetje lidhur me menaxhimin e problematikave gjatë praktikës profesionale dhe për temën e diplomës. Po ashtu institucioni mundëson lektorë të jashtëm kryesisht për çështje, module apo fusha të caktuara, që TBU, i ka aktivizuar në mënyrë të vazhdueshme. Numuri i kufizuar i studenteve në program, ka bërë që ngarkesa student pedagog në ndjekjen e praktikave dhe diplomave të jetë në shifra të arsyeshme dhe të justifikuar cilësisht. Për më tepër që shumica e studentëve i nënshtrohen provimit të formimit dhe pak prej tyre angazhohen në punim diplome ekuivalent me provimin e formimit. Në dokumentacionin e paraqitur nga insticioni përshkruhen me hollësi procedurat e zhvillimit të praktikës si dhe udhëzimet për punimin e diplomës.</p> <p><i>Aneksi shtese 01_ Udhezim për pergatitjen e temes se diplomes.</i> <i>Aneksi shtese 05_Vendim percaktimi drejtuesve praktikes mesimore 2018-2019.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<i>Aneksi shtese 13_Model flete vleresues diplomim me teme.</i> <i>Aneksi shtese 14_Model flete vleresues diplomim provim formimi.</i>			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Ky kriter nuk është i aplikueshëm 100% për programin në fjalë. Nga diskutimi me studentët ata kryesisht i kryejnë punimet në ambientet personale dhe jo në laboratorët e shkollës edhe për faktin se janë të punësuar. Sidoqoftë TBU ofron hapësira dhe laboratorë të pajisur me kompjutera dhe cdo akses tjetër të nevojshëm. TBU ka staf ndihmës për bibliotekën, sistemin EBSCO për aksesin në literaturën e huaj etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.6	
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Përmirësimi dhe rishikimi i programit MPABA me profile, sipas RVB është kryer ç’do vit. Kjo veprimtari realizohet nga vetë departamentet, anëtarët e tyre PAE dhe PAK, organizohen diskutime me menaxherë të fushave të biznesit, ku partneri kryesor është Balfin Grup, gjithashtu janë shfrytëzuar edhe programet e modilitetit ERASMUS. Rishikimi i programeve nënvizohet edhe në raportin e analizës vjetore të Fakultetit të Administrim Biznesit. Në të vetmin dokument që kishim në dispozicion për këtë problem, aneksin 38, analizën e realizimit të objektivave të programit, përshkruhet ky problem por nuk del e qartë në krahasim me një vit më parë apo edhe më shumë çfarë është përsosur, ndryshuar apo përmirësuar në syllabuset për cdo lëndë, apo në kurrikulën tërësore të programit, përveç spostimit në lëndën qeverisja e korporatave.
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimin të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimin të programit të studimit.	Nëpërmjet NJBSC institucioni ka filluar procesin e përfshirjes së studentëve në përmirësimin e programeve. Kjo kryhet nëpërmjet pyetësoreve të hartuara dhe analizuara. Sipas RVB secili departament angazhon 2-3 studentë të përzgjedhur nga grupet e programeve të studimit, në takimin e departamentit për rishikimin e programeve të studimit, veprimtari që edhe kjo duhej reflektuar në analizën pjesë e RVB. <i>Aneksi 38_Analize e realizimit të objektivave Programi Studimit MP Ab_18-19.</i>
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të	Institucioni ka kryer një studim për tregun pas diplomimit, iniciativë të cilën GVJ e konsideron si hap mëse i domosdoshëm për të garantuar vazhdimësinë e programit në aspektin sasior e cilësor dhe në lidhje me vendimet strategjike për programin por edhe me koordinimin administrativ të tij. Sugjerimet e studentëve lidhur me orët mësimore, sekretarinë dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




studimit.	<p>praktikën janë marrë në konsideratë nga institucioni dhe janë përmirësuar sic GVJ ka mundur të konstatojë nga intervista me studentët aktualë.</p> <p>Paralelisht zyra e ALUMNI në TBU në mënyrë të vazhdueshme ndjek studentët e diplomuar për të patur databazë me këta studentë. Kjo strukture kontakton dhe fton vazhdimisht studentët në veprimtari, diskutime dhe aktivitete të TBU. GVJ njih përpjekjen e institucionit për të përmbushur këtë kriter.</p>			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	<p>TBU ka një numër aktiv partnerësh private me të cilët bashkëpunon të cilët asistojnë në shumë aspekte duke filluar nga programet, sugjerimet për pranime, e finalizohen me punësimin. Në këtë kuadër organizohen veprimtari ekstra-kurrikulare, leksione të hapura, seanca për punësim apo ngritje në karrierë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Zhvillimi i procesit mësimor realizohet sipas metodave klasike me leksione dhe seminare. Sistemi i vlerësimit është 100 pikë, Senati Akademik i TBU ka miratuar rregulloren e programit dhe të procesit mësimor, ku përcaktohen dispozita të përgjithshme, pranimi i studentëve, rregullore e strukturës së programeve, kreditet minimale për avancimin në program, elementët e rregullimit të mësimdhënies, e kontrollit të dijeve, sistemi i vlerësimit me pikë e gërma për t'u standartizuar në plan ndërkombëtar, organizimi i provimeve, praktika, diplomimi, etj. Një element i vecantë është edhe fleksibiliteti i programit që u lejon studentëve të zgjedhin lëndë të ndryshme nga ato të bera në formimin bachelor. Neni 7 i rregullores pranon përshtatjen e individualizuar, me kërkesë të studentit dhe miratim të dekanit. Në vendim caktohen lëndët, plani mësimor individual, rregullimi i lëndës student pedagog, mënyra e ofrimit të literaturës, konsultimet, afati i kontrollit të ndërmjetëm e përfundimtar.</p> <p>Siç e kemi komentuar edhe në komentin 3 të standartit II.4, në parim kjo është ide atraktive dhe synon afrimin e ç' do studenti në varësi me interesat</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>e tij specifike. Kjo ide është reflektuar edhe në planin mësimor ku në semestrin e parë dhe të tretë njaft lëndë janë të papërcaktuara me synim që të përzgjidhen dhe individualizohen.</p> <p><i>Realizimi i saj siç konceptohet çënon frekuentimin si element i detyrueshëm, mësimdhënien dhe mësimnxënien në leksione dhe seminare që është gjithashtu e detyrueshme dhe kjo me synim rritjen e eficiencës së procesit mësimor, shfrytëzimin racional të burimeve akademike, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e dijeve në auditor dhe grup, ponderimin mbi bazë të barabartë të krediteve, trajtim të barabartë në vlerësim etj, dhe si e tillë gjykojmë se duhet reduktuar ndjeshëm. Për më tepër fleksibiliteti nëse realizohet gjërësisht sic e lejojnë programet çënon edhe formimin bazë dhe atë të profilit.</i></p> <p>GVJ konstatoi se TBU nxit zhvillimin e përdorimit të metodave interaktive dhe inovative të mësimdhënies. Stafit akademik është përfshirë në një program ERASMUS, ku ka mobilitete për student e pedagogë, me synim rritjen profesionale të tyre nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave. Nga takimi me stafin akademik dhe me studentet, GVJ konstatoi se përdorimi i metodave interaktive përfshinte përdorimin e softëare-eve të kontabilitetit apo case study dhe detyra kursi nga realiteti për t'i bërë modulet sa më praktike.</p> <p><i>Aneksi 5 Rregullore e Institucionit Aneksi 6 Rregullore e njësisë bazë; Aneksi 7 Rregullore e programit të studimit MPABA;</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Departamenti ndjek rregullisht ecurinë e procesit mësimor dhe monitoron rregullisht aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik dhe pedagogjik.</p> <p><i>Gjatë vizitës në institucion por edhe nga dokumentacioni i depozituar, nuk rezulton që të përdoren vlerësime të diferencuara midis pedagogësh dhe që synojnë stimulimin dhe inkurajimin e pedagogëve që aplikojnë metoda të reja dhe bashkëkohore.</i></p> <p>Monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik kryhet në mënyrë periodike nga departamenti dhe fakulteti përkatës nëpërmjet vlerësimit të performancës së tyre dhe nëpërmjet rezultateve të pyetësoreve të plotësuara nga studentët. Vlerësimi i performancës kryhet në fund të ç'do viti akademik, ndërsa pyetësori me studentët realizohet para provimeve dhe rezultatet e anketimit të përpunuara bëhen pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore.</p> <p><i>Rekomandohet që këto kontrole të kryhen në bashkërendim me NJSBC, rezultatet të jenë pjesë e analizës mësimore, e arritjeve të programit, e vendimarrjes për ndarjen e lëndëve dhe ngarkesës, të reflektohen në dosjen e cdo pedagogu, cfarë nuk u konstatua.</i></p> <p><i>Aneksi 6_Rregullore njësisë bazë_TBU. Aneksi 11_Rregullore e punesimit. Aneksi 40_Pyetesori i studenteve.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të</p>	<p>Departamenti dhe fakulteti organizojnë rregullisht metoda të përfshirjes së studentëve në vlerësimin e formave, metodave dhe nivelit të mësimdhënies. Forma më e përdorur për këtë është organizimi i anketave dhe pyetësorëve, të cilët përpilohen në bashkëpunim me zyrën e Karrierës dhe NJSBC. GVJ</p>

<p>vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>konstaton se studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve nëpërmjet dhe pyetësorëve (<i>Rregullorja e NJSBC, neni 6</i>), si edhe paraqitjes së ankesave kundrejt pakënaqesive të tyre lidhur me format e vlerësimit.</p> <p>Sipas konstatimit të GVJ rezultatet e pyetësoreve bëhen të ditura në mbledhje departamesh dhe trajtohen me sensitivitet përkundrejt pedagogut përkatës.</p> <p>Sugjerohet që pyetësoret të kryhen në bazë semestrale në koordinim me NJSBC dhe përfundimet t’ju bëhen të ditura dhe studentëve.</p> <p><i>Aneksi 13 Zyra e monitorimit të Kurikulës</i> <i>Aneksi 40 Pyetësi i studentëve</i></p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p><i>Zyra përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë që është ngritur dhe funksionon në nivel institucioni, është miratuar nga senati, bashkëpunon me studentët dhe departamentet, harton raporte dhe i bën ato objekt diskutimi dhe analiza në senatin akademik. Paralelisht njësi bazë dhe kryesore (Departamenti dhe Fakulteti) bëjnë publike rezultatet në analizën vjetore të njësisë. Këto rezultate fillimisht diskutohen në një mbledhje të hapur departamenti. Vetëm pas diskutimeve në departament dhe reflektimeve të ndryshme lidhur me problematikat e gjetura, kjo analizë miratohet dhe përcillet në Dekanat.</i></p> <p>Në aneksin 47 linku 7, pasqyrohet një analizë e plotë e institucionit, shumë planëshe, me aktivitetet mësimore, shkencore, etj.</p> <p><i>Elementët e mësipërm të sanksionuara drejtë, nuk i gjetëm në formën që trajtohet më lart në NJBSC apo edhe në departamentet për këtë program studimi, të reflektuara në analiza, diskutime dhe pjesë e dosjeve personale për avancim në karrierë dhe rregullimet e mundëshme.</i></p> <p><i>Aneksi 38 Analizë e realizimit të objektivave të Programit MPABA 2018-2019.</i> <i>Aneksi 47 link 9 Raportet periodike të NJBSC.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion parashikohet se Fakulteti i Administrimit Biznesit përdor mënyra për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Pyetësi i studentëve përdoret si mjet për të evidentuar dhe vlerësuar shembuj të mirë dhe efikas në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Rastet e specifikuar si pozitive nga studentët bëhen të ditura në mbledhjet e departamentit, siç na është konfirmuar edhe në takimet me përgjegjësen e departamentit. <i>Por në analizat vjetore të programit apo të procesit të mësimdhënies së Departamentit të Menaxhimit që mbulon këtë program, nuk ka të dokumentuar raste të diferencuara, shembuj të praktikave të mira apo emra pedagogësh apo lëndësh që duhen promovuar dhe inkurajuar, që janë të mirëvlerësuar dhe që janë për këtë shkak të diferencuar nga pjesa tjetër e stafit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi III.2																									
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.																									
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																								
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në procesin mësimor të programit MPABA me profile, kombinohet përdorimi i formave klasike të mësimdhënies, të gërshetuara midis tyre, si leksionet, seminarët, ushtrimet, punimet e kursit, punët e pavarura, orë laboratorike, praktikë profesionale, tema diplome, ku në varësi të lëndës dhe syllabllusit të miratuar, peshëzimi i elementëve, mënyra e vlerësimit, forma e zhvillimit të mësimin ndryshojnë.</p> <p>Programi përfshin 120 kredite, 24 kredite fitohen në semestrin e parë, 24 në semestrin e dytë, 24 në semestrin e tretë (viti dytë i studimeve) dhe 48 kredite në semestrin e katërt të cilat ndahen 12 kredite lëndët me zgjedhje, 11 kredite praktika profesionale, 10 kredite përvoja profesionale dhe projekti i menaxhimit, 14 kredite diploma apo provimi i formimit.</p> <p>Orët e programit dhe kreditet të alokuara në leksione dhe seminarë e element të tjerë sipas viteve janë në :</p> <table style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th></th> <th style="text-align: center;">Auditor</th> <th colspan="2" style="text-align: center;">Jashtë auditori</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Semestri I</td> <td style="text-align: center;">120/120</td> <td style="text-align: center;">24 Ects</td> <td style="text-align: center;">360</td> </tr> <tr> <td>Semestri II</td> <td style="text-align: center;">120/120</td> <td style="text-align: center;">24 Ects</td> <td style="text-align: center;">360</td> </tr> <tr> <td>Semestri III(V.2)</td> <td style="text-align: center;">120/120</td> <td style="text-align: center;">24 Ects</td> <td style="text-align: center;">360</td> </tr> <tr> <td>Semestri IV(V.2)</td> <td style="text-align: center;">60/60</td> <td style="text-align: center;">48 Ects</td> <td style="text-align: center;">1.080</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td style="text-align: center;">420/420</td> <td style="text-align: center;">120 kred</td> <td style="text-align: center;">2.160</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në procesin mësimor janë aplikuar edhe ftesa për personel akademik të jashtëm apo për personalitete të fushës të cilët kanë ofruar leksione të hapura dhe kanë sjellë në auditor eksperiencat e tyre apo të institucionave që kanë drejtuar. Praktika e pedagogëve të jashtëm, bashkëlektorë apo edhe titullarë lëndësh është e theksuar në praktikën e mësimdhënies në TBU dhe deri diku edhe në këtë program studimi.</p> <p><i>Aneksi 14.1_Plani mesimor MP AB 19-20.</i> <i>Aneksi 23_Te dhena Tabelore peroneli .akademik njesia kryesore_njesia pergjegjese.</i></p>		Auditor	Jashtë auditori		Semestri I	120/120	24 Ects	360	Semestri II	120/120	24 Ects	360	Semestri III(V.2)	120/120	24 Ects	360	Semestri IV(V.2)	60/60	48 Ects	1.080	Gjithsej	420/420	120 kred	2.160
	Auditor	Jashtë auditori																							
Semestri I	120/120	24 Ects	360																						
Semestri II	120/120	24 Ects	360																						
Semestri III(V.2)	120/120	24 Ects	360																						
Semestri IV(V.2)	60/60	48 Ects	1.080																						
Gjithsej	420/420	120 kred	2.160																						
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Bazuar në informacionet e grumbulluara në takimet me studentët dhe stafin akademik të programit të studimit, në lëndë të ndryshme, stafi akademik aplikon metoda të ndryshme të zhvillimit të procesit mësimor, në funksion të natyrës dhe veçorive së ç' do lënde.</p> <p>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve janë të paraqitura në syllabuset dhe programet e lëndëve e moduleve. Format e mësimin teorik e praktik janë: leksionet dhe seminarët të integruara, ushtrimet, praktikat profesionale, vizita studimore pranë bizneseve, detyrat e kursit/projektet e kursit, etj. Format e kontrollit të dijeve janë testimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe e projekteve të kursit, mbrojtja e praktikave profesionale, provimet e kursit. TBU organizon leksione të hapura nga lektorë të ftuar të huaj ose vendas si edhe konkurse apo forma të ndryshme mësimore. .</p>																								

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>Nuk rezulton të përdoren metoda të ndryshme dhe të diferencuara midis grupeve të ndryshme të studentëve. Stafit është i hapur për përmirësimin dhe pasurimin e metodave të mësimdhënies ndër vite.</p> <p><i>Aneksi 19 dhe 19.1 Syllabluset e lëndëve Programi MPAAB</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Stafi akademik, ka mundësi të përdorë mjete bashkëkohore të mësimdhënies siç janë mjetet audio-vizive, projektorë, aksesin në internet në sallën e mësimit.</p> <p>Stafi ka mundësinë të marrë pjesë në mobilitete, ku siç është konstatuar janë përdorur prej tyre.</p> <p>Sipas Aneksit 47 link 7, stafi i TBU ka kryer aktivitete të ndryshme ku stafi ka marrë pjesë. Gjatë këtij viti janë bërë dy aplikime për projekte kombëtare pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit të përmendura. Gjithashtu gjatë këtij viti u implementua me sukses projekti Erasmus+ për shkëmbim stafi dhe studentesh. Po gjatë këtij viti akademik, TBU riaplikoi për të njëjtin projekt Erasmus, i cili rezultoi fitues dhe do të implementohet gjatë vitit aktual.</p> <p>Në kuadër të Thirrjes Kombëtare të shpallur nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit për projekte kërkimore shkencore për vitin 2018-2020, Tirana Business University College (TBU) dhe Universiteti Polis kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi më 06/09/2018 për të aplikuar në këtë thirrje. Përmbajtja e këtij bashkëpunimi shikon TBU-në në rolin e aplikuesit dhe Universitetin Polis në rolin e partnerit në aplikim në projektin me titull: “Turizëm i Qëndrueshëm dhe Zhvillim në Zonat Malore Ndërkufitare: Shqipëri-Kosovë.</p> <p>Nga pikëpamja e bashkëpunimit TBU ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me komunat që vijojnë: Kukës, Gjakovë, Prizren (Kosovë), Kisela Voda (Shkup), Cair (Shkup) dhe Tetovë. Gjithashtu, në kuadër të këtij projekti TBU ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi edhe me Grupin Balfin, një aktorë i rëndësishëm në terma investimesh në këto rajone. Qëllimi kryesor i këtij projekti është ndërtimi i një “Konsorciumi” bashkëpunimi për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.</p> <p><i>Duke vlerësuar aktivitetet e TBU, shkallën e angazhimit të stafit të brendshëm e të jashtëm, rekomandojmë për shtimin e stafit të jashtëm trainime specifike e konsulta ndërkurikulare që synojnë përmirësimin e procesit të mësimdhënies apo përmirësimin e kompetencave didaktike. Gjykojmë se stafi akademik ka nevojë edhe për trajnime të karakterit pedagogjik dhe psikologjik vecanerisht të rinjtë angazhuar ndjeshëm dy vitet e fundit të programit për të njohur dhe marrë në konsideratë sjelljet e studentëve dhe individualitetin e tyre në formim, kulturë në karakter, temperament, etj.</i></p> <p><i>Aneksi 47 linku 7 dhe 8</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi plotëson kryesisht kriteret ligjore të kualifikimit, pasi ka lektorë të cilët janë angazhuar në mësimdhënie pa grada/tituj. Në kontrollin rastësor që GVJ kreu për dosjet e personelit u vërejt përputhje e profilit të lëndës me specialitetin e pedagogut. Personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive, përgjithsisht janë specialistë me përvojë praktike në fushat që mbulojnë. Ata kanë fituar një eksperiencë të kënaqshme në mësimdhënie, është harmonizuar gërshetimi i pedagogëve me përvojë</p>




	<p>ndonëse relativisht të rinj në moshë me angazhimin e ish studentëve master shkencor apo në proces doktorature.</p> <p><i>Aneksi 20 dhe 21 CV e personalit të Programit të Studimit MPABA</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni i jep rëndësi zhvillimit me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve. Institucioni, kryesisht njësia bazë, vlerëson format e mësimdhënies dhe analizon performancën e këtij procesi. Për këtë Departamenti, si strukturë që drejton programin, analizon periodikisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Cdo vit akademik bën një analizë të procesit mësimor dhe pedagogjik; • Analizon dhe diskuton përfshirjen e pedagogëve në kërkimin shkencor; • Realizon dhe tërheq opinionin e studentëve lidhur me format dhe metodat e mësimdhënies; <p>Kontrollet e vazhdueshme dhe leksionet e hapura të organizuara nga dekanati dhe departamenti identifikojnë problemet që duhen përmirësuar dhe vlerësojnë arritjet. Pjesë e reflektimit dhe organizimit të leksioneve të hapura janë edhe rezultatet e marra nga pyetësi i studentëve.</p> <p>Nuk është evidentuar ndonjë rast që të jetë realizuar ndryshimi apo reflektimi ndaj vrejtyeve dhe sugjerimeve të studentëve lidhur me mësimdhënien.</p> <p><i>Në këtë aspekt institucioni duhet të hartojë një procedurë monitorimi të gjetjeve nga pyetësorët, një plan pune nga komisionet përkatëse dhe një monitorim i përmbushjes së planit. Duke qenë se NJSBC është strukture e re GVJ konstatoi se në këtë aspekt ka vend për përmirësim.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Personeli akademik aplikon diskutime të lira dhe metoda të tjera interaktive në orët e mësimi që synojnë përfshirjen dhe gjallërimin e shprehjes së lirë të ideve dhe të inkurajimit të studentëve për të përfitur nga ky diskutim.</p> <p>Vetë struktura e programit, e syllabuseve, elementët e detyrimit të kaluara kryesisht në detyrat e kursit dhe projektet e kursit, përbërja e auditorit me studentë të punësuar mundësojnë diskutime dhe sjellje përvoja profesionale.</p> <p>Nga vizita në institucion konstatojmë se personeli akademik përpigjet që të angazhojë studentët me diskutime brenda fushës së lëndës apo realizojnë konkurse dhe vizita studimore, për ta bërë më tërheqëse orën e mësimi, të përdorë case study dhe inkuraojnë përvojat e tyre personale nga punësimi apo edhe njohuritë e tyre në objekt diskutimi në auditor, apo të përfshijë raste nga bizneset e ndryshme ku ata operojnë, duke ruajtur anonimitetin e të dhënave të përdorura.</p> <p><i>Aneksi 47 link 7: Raportet vjetore</i></p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Ky program studimi, ka në plan mësimor lëndë të formimit teorik klasike për programet master të kësaj fushe, dominojnë në formën e zhvillimit, detytimet dhe elementët përmbyllës të programit, puna praktike, detyrat e kursit, temat, raporti përvojës profesionale dhe projekti menaxhimit dhe përgatitja e diplomës që realisht kanë edhe numër të madh kreditesh. Midis pedagogëve dhe studentëve dominon respekti i ndërsjellë dhe reciprok si dhe fryma e ndërtimit të marrëdhënieve të ngrohta dhe komunitare.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




			X
--	--	--	----------

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Nga vizita në institucion u konstatua se TBU ka në dispozicion të procesit mësimor nja hapsirë prej 3 katesh të adaptuara me të gjitha sipërfaqet dhe ambientet e nevojshme për numërin e studentëve që ka në dy sistemet e shkollës bachelor dhe master, pasi mësimi zhvillohet paradite për sistemin bachelor dhe pasdite për sistemin master. Sipas orarit të mësimit për ç’do semestër, studentët zhvillojnë leksione dhe seminare në mjedise të mjaftueshme për numrin e studentëve, të grupeve mësimore dhe në përputhje me specifikën që kanë lëndët dhe modulet e këtij programi studimi. Ajo është e pajisur me mjete për ndriçim alternativ, rezerva të konsiderueshme uji, sistem kondicionimi gjatë gjithë vitit i shtrirë në të gjitha ambientet, internet, vende qëndrimi, sistem mbrojtjeje nga zjarri, ndihme të shpejtë etj.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	Nga vizita në institucion konstatohet se ambientet janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambiente përfshijnë salla, zyra, laboratorë. Sallat e leksioneve kanë projektorin, kompjuterin, lidhjen me internet, hapsira drite dhe ndriçim elektrik të mjaftueshëm. Ka ambiente zyra, për stafin pedagogjik dhe stafin ndihmës si dhe sistem ngrohjeje. Me sipërfaqet dhe ambientet që disponon TBU plotëson kriteret sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”, sipas të cilit kërkohen 2.5 m ² / student. <i>Aneksi 42_Mjediset e Fakultetit AB.</i>
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Sipas RVB, TBU disponon zyra për personelin akademik me kushtet e nevojshme nga pikëpamja infrastrukturore për të realizuar punën e tyre akademike dhe procesin mësimor. Interneti është i aksesueshëm edhe në auditore në funksion të procesit msimor dhe në disa salla ka edhe disa kompjutera të mjaftueshme për të ilustruar ç’ështëjet qe diskutohen edhe me grupe studentësh. Ndërkohë bëhet rregullisht mirëmbajtja e pajisjeve. Nëpërmjet sekretarisë, apo edhe mjeteve online të TBU njoftohen studentët mbi pëmbajtjen e lëndëve, pedagogun, kontaktet e tij, orarin mësimor, etj. TBU zotëron rreth 80 kompjutera (desktop dhe laptop), relativisht të mjaftueshme për numurin e studentëve që ndjekin TBU në të gjitha sistemet.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara	Literatura bazë për ç’do modul të ofruar në këtë program studimi ofrohet në gjuhën e huaj dhe ne disa raste edhe ajo shqipe. Baza mësimore përfshin material bazë të përcaktuara në syllabluse në anglisht, tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt. Biblioteka përgjithsisht disponon tituj bazë shqip dhe materiale mbështetëse. Po ashtu sistemi online ku TBU është e abonuar prej vitesh ofron edhe titujt e rekomanduar për ç’do lëndë e fushe në gjuhë të huaj, kryesisht në anglisht. <i>Nga vizita në Bibliotekë</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>në programin e studimit.</p>	<p><i>rezulton se numri i teksteve në shqip të botuara nga autorë vendas në universitete të ndryshme publike e jo publike nuk është i pranishëm dhe hera herës ndeshen botime të vjetra. Megjithatë, studentët dhe pedagogët mund të aksesojnë artikujt të ndryshëm si materiale mbështetëse nëpërmjet abonimit që institucioni ka bërë në EBSCO me rreth 40.000 tituj që sipas konstatimit tone në bibliotekë shfrytëzohej në nivele modeste, kur nëse sheh syllabluset e lëndëve të programit dominojnë me mbi 90 përqind materialet e rekomanduara në anglisht.</i></p> <p><i>Aneksi 45_Database e teksteve Biblioteka.</i> <i>Aneksi 47_Te dhena nga faqja zyrtare ëeb, linku 31.</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka synon të vëre në dispozicion të studentëve nëpërmjet tekstet mësimore të përcaktuara në syllabuse-t e lëndëve dhe literaturë ndihmëse të nevojshme, përzgjedhur mbi bazë të planit të hartuar nga përgjegjësi i programit.</p> <p>Nga vizita në institucion rezultoi që biblioteka nuk përdoret shumë nga studentët dhe ka mungesa në tekstet e detyrueshme. <i>GVJ rekomandon që fondi i bibliotekës, në gjuhën shqipe, duhet te pasurohet në mënyrë të vazhdueshme, duke synuar reflektimin e ndryshimeve cilësore të programit të studimit si edhe azhornimin me zhvillimet më të fundit të literaturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB-së ku vihet theksi për aksesin në librarinë online, rezultoi nga vizita në institucion, se ajo nuk përdoret në nivelin e synuar nga programi dhe syllabuset, nga studentët me të cilët GVJ zhvilloi takimin.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>TBU ka salla leksionesh dhe ambiente studimi në bibliotekë të cilat janë në funksion të studentëve për realizimin e detyrave të kursit, diplomave apo edhe prezantimin e tyre. Në funksion të mësimdhënies dhe zhvillimit bashkëkohor të saj është edhe një laborator i teknologjisë informacionit. Ndonse studentët në vendet ku punojnë apo edhe personalisht përgjithsisht disponojnë akses online, rekomandojmë përdorimin më intensiv të laboratorëve dhe aksesit online në procesin mësimor, për më tepër që literatura e rekomanduar është në gjuhë të huaj kryesisht dhe siç u theksua në komentimin në standartin III.3 kriteri 4, shkalla e përdorimit individual të aksesit në bibliotekë është në nivele modeste nga studentët.</p> <p><i>Aneksi 46_Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit.</i></p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Platforma online (e-learning) u aplikua disi kohët e fundit për shkak të pandemisë dhe ky problem mbetet i hapur edhe për periudhën në vazhdim, pra mbetet një sfidë për t'u mbështetur dhe konsoliduar për TBU. Sipas RVB, institucioni po investon, lancon e teston një sistem online interaktiv (Sistemi i manaxhimit të studentëve), që mundëson aksesin për informacion për notat, komunikim me stafin, aksesin për materialet mësimore, eventet e TBU, pagesat e tyre, etj. Në këtë sistem do të përfshihen dhe kenë aksesin që iu intereson edhe zyrat ndihmëse të TBU. <i>GVJ inkurajon implementimin sa më parë të këtij sistemi që lehtëson dhe përmirëson menaxhimin, eficiencën dhe performancën e institucionit, por edhe të programit MPABA</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<i>me profilet e tij.</i> Aktualisht nga pedagogët përdoren sistemet google Classroom apo Dropbox për komunikimin e materialeve mësimore me studentët.			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Sipas RVB, TBU dhe studentët ë këtij programi studimi, komunikojnë kryesisht në rrugë elektronike (email), sic u trajtua në kriterin 3 të këtij standarti, sekretaria komunikon dhe njofton studentët për të gjithë elementët e ecurisë së procesit mësimor, orarin, materialet mësimore, pedagogët, materialet didaktike. Sic u theksua në kriterin 8 TBU është në proces aksesimi e implementimi të një sistemi online interaktiv për menaxhimin e procesit mësimor dhe aspekteve kryesore të menaxhimit të institucionit e programit në fjalë.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Studenti ka të drejtë të propozojë sipas dëshires se tij tezën e diplomës që kërkon të zhvillojë, të zgjedhë udhëheqësin e tij dhe në bashkëpunim më të, të përcaktojë temën kërkimore që do të realizojë për mbrojtje. Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat specifike të studentëve, duke i harmonizuar ato me kushtet aktuale. Tezat e diplomës dhe pedagogët që do të udhëheqin punimin e tyre, përcaktohen nga departamenti dhe miratohen nga Dekani i fakultetit. Gjatë punës kërkimore për arritjen e objektivave të përcaktuara në realizimin e punimit të diplomës, udhëheqësi asiston gjatë gjithë kohës studentin dhe e mbështet atë për përmbylljen me sukses të saj. Nga vizita në institucion u konstatua se studentët kryesisht i nënështrohen provimit të formimit dhe disa prej tyre zhvillojnë punim diplome. Kjo është në përzgjedhje të tyre dhe mundësive për akses në informacion që duke patur parasysh prezencën e dukshme në detyra e punë kursi apo projekte, si dhe aksesin e mundshëm për informacione nga studentët të punësuar thuajse 100%, mendojme se edhe prezenca e temave të diplomës mund të ishte më e madhe. <i>Problematika mendojmë se është evidentimi i plagjiaturës, për diplomat dhe detyra kursi, për të cilën duhet menduar për një softëare të dedikuar, apo forma të tjera.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	NJBSC është strukturë e ngritur dhe në funksionim nga TBU, prej disa vitesh dhe e rinovuar me anëtarë të stafit. Në zbatim të kërkesave të Ligjit 89/2015 mbi arsimin e lartë, në TBU është ngritur edhe komisioni i cilësisë në nivel të njërive kryesore. Ngritja dhe funksionimi i tyre mbështetet në statutin e TBU dhe në rregulloren për organizimin e organeve kolegjiale. Raporti që hartohet nga NJBSC përfshin problematika të zhvillimit të procesit mësimor, në aspektin e cilësisë, respektimin e syllabuseve, rezultate të anketimeve me studentë dhe gjetjet e tij bashkërendohen me Departamentin e angazhuar në këtë program, me synim përmirësime dhe rregullime.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p><i>Aneksi 2_TBU_statuti.</i> <i>Aneksi shtese 09_Rregullore për funksionimin e organeve kolegjiale.</i> <i>Aneksi shtesë 47 Link 7 Raportet vjetore</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Fakulteti i Administrim Biznesit dhe Departamenti i Menaxhimit janë respektivisht njësia kryesore dhe bazë që kanë përgjegjësinë akademike por edhe administrative për ecurinë dhe performancën e programit. Dekani si drejtues i fakultetit dhe përgjegjësi i departamentit, si njësi bazë, duke u mbështetur në kontrollin e vazhdueshëm dhe masave të marra, të leksioneve të hapura të organizuara, si dhe të analizës së vazhdueshme të punës mësimore dhe kërkimit shkencor, synojnë frymën e përgjegjësisë individuale të personelit akademik për rritjen e cilësisë së mësimdhënies në këtë program studimi.</p> <p><i>Aneksi 7 Rregullore e programit MPABA</i> <i>Aneksi38 Analizë e realizimit të objektivave të Programit</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Leksionet e hapura nga lektorë dhe personalitete të fushave specifike, të ftuar të huaj dhe vendas, pjesëmarrja e stafit akademik në projektet e mobilitetit me universitete të huaja, (Staffordshire University UK), konferenca shkencore brenda e jashtë vendit, pjesëmarrja e studentëve në punë shkencore, kanë rritur nivelin e kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Ky është një proces që nevojitet të thellohet e avancohet nga pikpamja sasiore e cilësore.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Aktivitetet kërkimore-shkencore të pedagogëve duke përfshirë edhe studentët në konferenca studentore, zenë një vend të rëndësishëm në fokusin e aktiviteteve të TBU, me objektiv të drejtpërdrejtë rritjen e cilësisë së dijeve të studentëve. Rritja e nivelit shkencor individual të pedagogëve nëpërmjet botimeve të ndryshme shkencore, pjesëmarrjes në konferenca brenda dhe jashtë vendit transmeton në procesin mësimor sinjale të rëndësishme të kërkesave të tregut dhe aktualizon dijen në çdo fushë studimi. Kjo gjë konfirmohet dhe në CV-të e stafit akademik që shikohet se në këto vitet e fundit kanë rritur nivelin e kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor. Nga RVB dhe vizita në institucion vihet re edhe pjesëmarrja e studentëve dhe pedagogëve në projektin ERASMUS me shkëmbim stafi dhe studentësh, zbatuar deri tani në dy periudha Janar-Maj 2018 dhe Shtator-Tetor 2019 me Staffordshire University UK dhe vijimi i tij i parashikuar me Universitetin Beiefeld me të njëjtat shkëmbime e mobilitete. Ky kualifikim i personelit akademik të fakultetit dhe departamentit ka ndihmuar dukshëm në përmirësimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies.</p> <p><i>Aneksi 20_CV_Stafi Akademik Programi Mp_AB.</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në vazhdimësi personeli akademik i Fakultetit të Administrim Biznesit dhe departamentet përkatëse kualifikohen brenda institucionit në kuadër të marrëveshjeve me institucione të tjera homologe përmes tryezave të rumbullakta, diskutimeve, leksioneve të hapura që i kanë shërbyer trjanimit të stafit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe të metodave të reja në mësimdhënie.</p> <p><i>Aneksi 47_Te dhena nga faqja zyrtare ëeb.</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik</p>	<p>Sipas RVB, ka qënë dhe është në përgjegjësinë e personelit akademik</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>zbatimi i programeve të studimit si dhe transmetimi i metodave të reja në mësimdhënie dhe praktikave mësimore tek studentët. Ky është një detyrim i cili rrjedh nga marrëdhëniet e punës që ka stafi akademik në lidhje me realizimin e procesit mësimor të përcaktuara në kontratën e punës. Në fillim të semestrit pedagogu harton planin kalendar të zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, që firmoset nga ai dhe përgjegjësi i departamentit. Pedagogu është përgjegjës për të gjitha zërat e detyrave që ai ka në marrëdhënie me studentët për organizimin dhe zhvillimin e mësimin si dhe plotësimin e detyrave që i ngarkon departamenti.</p> <p><i>Aneksi 38 Analizë e realizimit të objektivave të programit;</i> <i>Aneksi 47 link 9</i></p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Një nga synimet që TBU ka është implementimi i inovacionit edhe në fushën e mësimdhënies. Gjatë takimit që GVJ pati me stafin akademik u theksua se prej tyre synohej një mësimdhënie dhe komunikim interaktiv duke shmangur në maksimum mësimin tradicional ku lektorët janë folës dhe studentët dëgjues. Sipas tyre, kjo mënyrë e mësimdhënies ishte më efektive sepse shmangte monotoninë dhe rriste vëmendjen dhe përfshirjen e studentit në orën e mësimin.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Stafi akademik i Fakultetit të Administrim Biznesit dhe programi në analizë, angazhon profesionistë të fushës, lektorë e profesionistë të ftuar, jashtë fushës akademike, të cilët kontribuojnë me eksperiencat, idetë, njohuritë konkrete të tregut për përmirësimin e programeve.</p> <p><i>Aneksi 47_Te dhena nga faqja zyrtare ëeb, Link 8.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se rregullorja e programit të studimit ka të përcaktuar sistemin e vlerësimit me notë. Kjo rregullore është e publikuar në ëeb-in e TBU. (Aneksi 47, link 1). Sipas syllabuseve të programit, metodat e vlerësimit përfshijnë testimet, detyra kursi, teste me alternativa përgjigjesh punë apo projekte kursi individuale apo në grup në varësi të lëndës dhe provime përfundimtare.</p> <p>Kontrolli i njohurive të studentëve sipas rregullores së programit realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - angazhimit në diskutime gjatë leksioneve e seminareve, por edhe në formë detyrash të kontrolluara përgjatë zhvillimit të lëndës;

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>- detyrave të kursit për problematikën që mbulon lënda.</p> <p>- provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar mbi bazën e materialeve të trajtuara përgjatë zhvillimit të lëndës;</p> <p>Mënyra e vlerësimit dhe kriteret i bëhen me dije studentëve që në fillim të vitit akademik dhe janë pjesë përbërëse e syllabuseve të lëndëve. Sic u komentua edhe në kriteri 4 të standartit II/3:</p> <p><i>Skema e vlerësimit nuk është e njëjtë në të gjitha lëndët, në mjaft lëndë mënyra e kontrollit të dijeve dhe vlerësimit dominohet nga detyrat apo punët e kursit dhe në disa të tjera janë respektuar kërkesat e ligjit si 30-40 përqind vlerësimi vjetor (frekuentim, detyra kursi, test i ndërmjetëm dhe 60-70 përqind testi përfundimtar). Në syllabuset e paraqitura pjesë e DVV, vihen re lëndë me 60% detyra dhe frekuentim dhe 40 % testi përfundimtar. Ripërsërisim rekomandimin.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që ky konstatim të jetë objekt diskutimi dhe përsosjeje në departamentet respektive dhe në mënyrë të përmbledhur për programin nga njësia kryesore me synim përafrimin e elementëve të syllabluseve në frymën e kërkesave të VKM, duke respektuar edhe lirinë akademike.</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i DVV dhe vizita në institucion konstatuam se pedagogu i lëndës para fillimit të ç’do semestri bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat dhe temat e lëndës si dhe elementët e tjerë të syllabusit. Gjithashtu i njeh studentët me metodologjinë e vlerësimit të dijeve gjatë semestrit dhe me përfundimin e lëndës Studentët informohen rregullisht, në fillim të ç’do semestri dhe përgjatë tij lidhur me lëndët, me syllabuset e ç’do lënde dhe me kërkesat e programit për studentët. Ata njohin detyrimet e tyre dhe kohën e përmbushjes së këtyre detyrimeve. Alternimi i mbi 3 pedagogëve në të njëjtën lëndë krahas avantazhit për thithjen e stafit më të kualifikuar dhe diversifikimit të përvojave, krijon një lloj konfuzioni në hartimin, ndjekjen, mbrojtjen e detyrave të kursit por edhe detyrimeve të tjera, si i tillë kërkon rritjen e vëmendjes dhe bashkërendimit midis stafit.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit (Aneksi 7), në syllabuset e lëndëve janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që i ka përvetsuar studenti gjatë zhvillimit teroik e praktik të lëndës/modulit si aktivizimi në mësim, testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final. Vlerësimi dhe testimi i njohurive realizohet në forma të ndryshme.</p> <p>Më të përdorura në këtë program studimi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi me punime të pavarura, ose detyra kursi, të cilat realizohen në grup dhe që studentët kanë në dispozicion 10 % te vlerësimit vjetor nga ky element; - Për cdo lëndë, ka edhe një kontroll ose vlerësim të pjesshëm, që ka 30% të vlerësimit vjetor; - Vlerësimi përfundimtar që ka 60 % të vlerësimit vjetor; <p>Tezat e provimit dhe të kontrollit janë gjithëpërfshirëse dhe mesatare. Grafiku i provimeve hartohet nga përgjegjësat e departamenteve dhe miratohet nga Dekani. Grafikët e provimeve shpallen para fillimit të sezonit. Në formën e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë. Tezat e provimit hartohen nga pedagogu i lëndës, dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Pavarësisht cdo lënde struktura varion nga njëra lëndë në tjetrën. <i>Ritheksojmë komentin dhe rekomandimin e bërë në kriterin 1 të këtij standarti dhe në atë të standartit II/3 kriteri 4</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Nga verifikimet u konstatua që vlerësimi i njohurive, aftësive dhe dijeve të studentit realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe studentët janë njohur me të në rregulloren e Fakultetit dhe rregulloren e Departamentit.</p> <p>Ky vlerësim ndahet në dy pjesë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit; 2. Vlerësimi përfundimtar; <p>Këto programe miratohen ç’do vit nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>Rekomandojmë që vlerësimi final të ketë peshën përcaktuese, ashtu siç e përcaktojnë edhe VKM përkatëse, kjo me synimin që studenti të gjithë njohuritë e vitit të përfituara dhe interpretuara sipas rastit në detyrat e kursit, ti reflektojë në formimin e tij përfundimtar dhe studentët të vihen në një bazë më të barabartë objektive vlerësimi.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Për zbatimin e këtij kriteri, deri më tani korrigjimet bëhen nga pedagogët. Nga vizita në sekretari, dhe diskutimi me pedagogët, pikët e akumuluar dhe vlerësimi përfundimtar janë transparente tek studentët. Nëse ka ndonjë ankesë, studentët drejtohen në njësinë bazë të cilët ndjekin procedurën e përcaktuar në rregullore.</p> <p><i>Sugjerohet përdorimi i një sistemi elektronik për të rritur transparencën në vlerësim. TBU i ka forcat, kapacitetet ta realizojë këtë, kjo realizon një vlerësim objektiv, por mbi të gjitha nxit punën dhe meritën konkrete të përgatitjes konceptuale dhe formimin e cdo studenti pas aplikimeve praktike të demonstruara në detyra kursi sipas eksperiencave të gjithsejçilit ku punon.</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Përgjegjësi i departamentit së bashku me komisionet e lëndëve janë përgjegjese për krijimin e komisioneve të provimit. Në përbërjen e tij sipas përvojës së TBU ka 2-3 anëtarë dhe në mjaft raste kanë qënë të tre bashkelektorë. Njëri prej anëtarëve është pedagogu titullar nga i cili buron lënda/moduli dhe që është përcaktuar në syllabus, apo ka të njëjtin profil ose të përafert. Komisioni i provimit si rregull përcaktohet nga përgjegjësi i Departamentit dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit.</p> <p><i>Aneksi shtesë 10 Rregullore e mbarëvajtjes së procesit mësimor</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<i>Aneksi shtesë 11 Miratimi nga dekani i komisioneve të provimeve të formimit</i>
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Vlerësimi i njohurive dhe dijeve me shkrim behet, i sekretuar nga sekretaria mësimore. <i>Aneksi shtesë 10_Rregullore për mbarëvajtjen e procesit mësimor.</i>
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Fleta e provimit ka rubrikën për pikët e vlerësimit dhe feed-back lidhur me rezultatin e vlerësimit. Sipas rregullores së programit, ç’do student mund të ankimojë rezultatin e vlerësimit. Nga takimi me studentët u informuam që ata që në fillim të lëndës orientohen nga pedagogët në lidhje me programin e lëndës dhe detyrimeve të saj, me testimet e ndërmjetme, me pikët që i korespondojnë atyre, me strukturën e detyrave e projekteve të kursit. Studentët instruktohen si do të realizojnë detyrën e kursit, apo projektin që në fund të lëndës apo modulit sipas rastit prezantohet nga studentët para kursit të tyre dhe pedagogut të modulit (kjo bëhet në forma të ndryshme sipas rastit në ppt, foto, video në orët e fundit të seminareve). Ky proces ballafaqimi me një audiencë të caktuar ndihmon studentët të përmirësohen në drejtim të mësimnxënies si dhe të fitojnë/ përmirësojnë aftësitë e tyre prezantuese. <i>Lipset të shtrihet mbrojtja e prezantimi i detyrave gjërisht, në cdo lëndë të programit, ndonëse mund të konsumojë kohë, kjo është një shkëmbim përvoje me auditorin present, përgjegjësi e seriozitet nga student si dhe unifikim kërkese.</i> <i>Aneksi 5_Rregullore e Institucionit_TBU.</i>
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Komisionet e provimit përbëhen nga të paktën dy pjestarë të stafit akademik të miratuar sipas përcaktimit të rregulloreve. Rekomandohet teza në dy e më shumë variante të ndryshme për cdo sezon provimi. Gjithashtu tezat e viteve paraardhëse por edhe përmbledhje materiale mund tu vihen në dispozicion studentëve me synim rritjen e angazhimit të tyre në përgatitje. Personeli akademik që ndjek procesin e provimit u ndalon hyrjen në provim personave të jashtëm, nga TBU, me përjashtim të drejtuesit të departamentit apo personave të tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani/Rektori/Rektorati për kontroll. Studentëve nuk u lejohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve në provim. Për temat e diplomës, ndonëse janë në numër të vogël në raport me numërin e studentëve që diplomohen sepse përdoret provimi i formimit, udhëheqësi mban kontakte me studentin si dhe i kërkon informacion të detajuar për literaturën e përdorur në secilën nga pjesët e punimit dhe mënyrën e referimit të saj. <i>Duke patur parasysh numërin e lartë të temave të kursit dhe projekteve të kursit në të gjitha lëndët e programit dhe peshën që ato zënë në rekomandojmë që institucioni të investohet në sigurimin e sistemit të kontrollit të plagjiaturës, që tashmë po shtrohet në sistemin universitar në mjaft shkolla apo sisteme në rajon.</i> <i>Aneksi shtesë 10: Mbarëvajtja e procesit mësimor</i> <i>Aneksi 9 : Mbi sekretarinë mësimore</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Proçesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në përputhje me programin e studimit. Gjatë kontrollit stafi shënon pikët për ç’do pyetje, rubrike, ushtrim, brenda një jave, rezultatet i dorëzohen sekretarisë mësimore, kjo e fundit në mënyrë konfidenciale njofton me email studentët, pas kësaj rezultatet dhe pas rishikimit përfundimtar, rezultatet hidhen në sistem, dhe ndërkohë edhe hartohet proces verbali lëndës.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Pas shpalljes së rezultateve studenti sipas rregullores se programit të studimit, brenda 3 ditëve nga njoftimi me rezultatin e ankimon ose jo, ankimimi i njoftohet pedagogut të lëndës. Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit dhe në dorëzimin e tij në sekretarinë mësimore. Provimet me shkrim të studentëve ruhen nga pedagogu i modulit për një periudhë gjashtë mujore pas përfundimit të sezonit të provimeve.</p> <p><i>Aneksi 5_Rregullore e Institucionit_TBU.</i> <i>Aneksi shtese 47 link 9 : Raportet vjetore te monitorimit të cilësise</i> <i>Aneksi 9 Mbi sekretarinë mësimore.</i></p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Nga takimi me studentët rezulton se studenti ka të drejtë të ankimohe brenda 3 diteve në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zvillimit të provimeve ose nuk është dakort me vlerësimin e bërë. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit, ose brenda 72 orëve. Kjo për probleme proceduriale apo etike. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime përgjegjës të departamentit përkatës, komisionin e provimit, si dhe vetë studentin. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Ky vendim është i formës së prerë. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studentin është ankuar dhe vendos në bashkëpunim me përgjegjës të Departamentit, që studentin të rijapë provimin. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në dekanat.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë nëpërmjet të cilave studentin thëllon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të manaxhimit dhe vendimmarrjes së biznesit.</p> <p>Programi përmban lende te formimit bzik dhe professional gjithëplanesh, nga fusha e biznesit, marketingut, finances, kontabilitetit,dhe si i tille</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




studentëve.	<p>kompleton njohurite teorike dhe aplikative dhe rrit kompetencen e te diplomuarit në analiza, studim, vendimarrje konkrete në fushen e biznesit.</p> <p><i>Aneksi 7_Rreg_progr_stud_MP_AAB.</i> <i>Aneksi 14.1_Plani mesimor MP AB 19-20.</i> <i>Aneksi 19 Syllabuset e Lendeve MP AB.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Modulet janë të ndara në lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse, sipas ligjit. Nuk përfshihen lëndë në gjuhë të huaj ndonse literatura e rekomanduar në të gjitha syllabluset është thuajse 100 % në gjuhë të huaj dhe frekuentimi dhe aksesimi real i saj në bibliotekë është në nivele modeste. Ritheksojmë komentin e bërë në standartin I/4 kriteri 2, për orientimin e profileve sipas strukturës bazë dhe karakterizuese të programit dhe mundësinë e krijimit të ndonjë profili të ri brenda programit MPABA, duke eliminuar kështu individualizimet në program për studentë individë dhe zhvillimin e mësimit për ta mbi baze konsultimi e rekomandimi materialesh.</p> <p><i>Aneksi 7 Rregullore e programit të Studimit MPAAB</i> <i>Aneksi 14.1 Plani mësimor I programit MPAAB</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Në syllabuset e ç’do lënde studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në modulën përkatës. Këtu ato njihen me temat, kohëzgjatjen e kursit, frekuentimin, mënyrën e vlerësimit, si dhe literaturën bazë dhe plotësuese. Syllabusi përmban edhe numrin e krediteve të lëndës.</p> <p>Në përfundim të lëndës studentët japin vlerësimin e tyre me anë të anketimeve për disa elementë të mësimdhënies dhe mësimnxënies që lidhen edhe me ecurinë e programit dhe syllabuseve. <i>Kjo bëhet edhe objekt i analizës mësimore ndonëse gjatë vizitës në institucion nuk e gjetëm këtë material.</i></p> <p><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lendeve MP AB.</i> <i>Aneksi 40_Pyetesori i studenteve.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Në fund të lëndës apo modulit, pedagogët e moduleve realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synoheshin të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të modulit. Studentët orientohen në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin final, strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi lëndës.</p> <p><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lendeve MP AB.</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në këtë program studimi organizohen leksione të hapura nga personeli akademik dhe lektorë të ftuar për tema të veçanta dhe që janë me interes për studentët. Përparësi dhe vecori e TBU dhe e programit në fjalë është angazhimi i mjaft pedagogëve të jashtëm me ekspertizë profesionale të spikatur për fushat që ftohen ose angazhohen, studentët zhvillojnë paralelisht procesin mësimor dhe praktikën profesionale, hartojnë raport të posacëm për këtë dhe e mbrojnë para një komisioni në program. Ndërkohë në thuajse shumicën e detyrave të kursit ata orientohen të sjellin komponentë, përvoja dhe zhdihje praktike nga fushat që mbulojnë.</p> <p><i>Aneksi 47 link 5,8,11,</i> <i>Aneksi 34 Marveshje bashkepunimi me institucione te ndryshme.</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>GVJ konstatoi se përbërja e kurrikulës së programit të studimit, lëndët dhe modulet që e përbëjnë atë, janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që ti pajisin studentet me aftësi për tju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Kurikula e programit të studimit dhe plani mësimor, shtrirja e praktikës gjatë dy viteteve të studimit, kryerja e saj kryesisht në vendet ku punojnë studentët, ju jep mundësinë studentëve për ti zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e fituara në trajtimet e programit të studimit në praktikë.</p> <p><i>Aneksi 19 dhe 19.1 mbi syllabuset e lëndëve te programit</i></p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve/moduleve të programit të studimit u japin mundësinë studentëve të realizojnë detyra e kursit (apo projektet e kursit), në lëndët/modulet ku ajo është pjesë e planit mësimor. Fakti që studentët janë të punësuar e bën më real, profesional dhe objekt debati përgatitjen dhe prezantimin e temave dhe detyrave të kursit, pasi studentët vijnë nga fusha ekspertize dhe interesi që mund të kontribuojnë cilësisht në debat.</p> <p><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lendeve MP AB.</i> <i>Aneksi 19.1 Syllabuset e Lendeve MP AB.</i></p>			
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Nga vizita dhe takimi me studentët, konstatoam se personeli akademik krijon një klimë të përshtatshme për mbështetjen e studentëve dhe angazhimin e tyre në studime e në punë kërkimore-shkencore. Angazhimi i studentëve në kryerjen e detyrave të kursit, si një detyrim i programit i ka mundësuar atyre që të kryejnë vetë studime më të thelluara kërkimore e shkencore. Rekomandojmë TBU të organizojnë më shume takime, konferenca apo tavolina të rrumbullakta me studentë dhe ish studentë të udhehequr nga pedagogët pasi edhe materiali i mundëshëm prezantues është nga fusha me interes dhe kontribuon edhe në drejtimin ekstrakurikural. Për më tepër që TBU ka një numur studentësh sipërmarrës.</p> <p><i>Aneksi 47_Te dhena nga faqja zyrtare ëeb, Link 12.</i></p>			
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Sipas RVB dhe gjatë vizitës në institucion u konstatua se institucioni nëpërmjet 'Inkubatorit të Biznesit' krijuar në vitin 2016 ka mbështetur iniciativa inovative financiare.</p> <p><i>Sugjerohet që kjo mundësi të zgjerohet qoftë edhe për studentët e këtij programi studimi, pasi formimi i tyre, punësimi, mënyra e zhvillimit të programit, etj, mundësojnë qe edhe ndërmjet tyre dhe pedagogëve të brëndshëm dhe jashtëm ka ide dhe iniciativa që duhen mbështetur dhe inkurajuar financiarisht dhe institucionalisht.</i></p> <p><i>Aneksi 47_Te dhena nga faqja zyrtare ëeb, Link 18.</i></p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Për rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe për tu dhënë atyre aftësi praktike, personeli akademik i departamentit, në vazhdimësi ka ndërthurur format e mësimdhënies me vizita në institucione të tjera brenda vendit më të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. Nga takimi në institucion na u komunikua që nuk ka pasur interes nga studentët master, për mobilitetin në kuadër të marrëveshjeve që ka TBU, pasi ata janë edhe në marrëdhënie pune.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	----------

Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	TBU ka mareveshje aktive bashkepunimi me biznese private kryesisht por edhe institucione publike, të cilat shfrytëzohen edhe për praktikën profesionale të studentëve të programeve master. Balfin Grup sipas marveshjes ka akomoduar me bizneset e saj numurin kryesor të praktikantëve. Praktika është shtrirë gjatë viteve të studimit, dhe institucioni dhe njësia bazë ka programuar, ndjekur, vlerësuar procesin dhe studentët. Shumë nga studentët kanë zhvilluar praktikën e tyre në vendin e tyre të punës. <i>Aneksi 32_Tabele permb. institucionet bashkepunuese.pdf</i>			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Praktika profesionale përfundon me një raport mbi eksperiencën e fituar. Mbrojtja e saj bëhet para komisionit të praktikës ku studenti paraqet raportin e përgatitur sipas nje formati me rubrika të caktuara. Mbrojtja me sukses i ofron studentit 12 kredite. <i>Aneksi 18: Rregullore per praktikën profesionale</i>			
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale vlerësohet me 22 kredite, 12 kredite ECTS mbrojtja e praktikës dhe 10 kredite Raporti i përvojës profesionale. Gjykojmë se ky raport me kaq kredite është një komoditet dhe dublon disi kreditet per raportin e praktikës profesionale dhe minimizon kreditet për diplomën. IAL i ka kushtuar nje vemendje institucionale dhe programore praktikes profesionale, rritjes se cilesise dhe perfitueshmeriser nga ajo, menyres se ndjekjes dhe vleresimit te saj, si dhe te diplomimit pas saj, kryesisht nepermjete provimit te formimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.9 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Nga verifikimi i GVJ, diplomimi studentëve në këtë program bëhet me provim formimi dhe në raste të vecanta me mbrojtjen e një punimi diplome. Kriteret dhe procedurat e diplomimit përcaktohen në rregulloren e programit të studimit. Njësia bazë, sipas RVB komunikon në fillim të semestrit të dytë me studentët duke i orientuar të komunikojnë me departamentet lidhur me formën e diplomimit. <i>Duke patur parasysh forcat udheheqëse, stafin e kualifikuar me grada e</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<i>tituj PAE por edhe PAK, mundësitë e informacionit nga vetë studentët në vendet ku punojnë por edhe aksesit që mundëson TBU nga marrëveshjet e bashkëpunimit sugjerojmë rritje e numërit të studentëve me punim diplome, nisjen e procedurave për diplomën nga departamentet përkatëse që gjatë semestrit të parë dhe punimet e diplomave master të publikohen në faqen e internetit të TBU.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Struktura përgjegjëse e këtij programi është Departamenti i Manaxhimit, që sipas rregullores i bën të ditur studentëve kriteret e diplomimit. Për këtë angazhohet stafi akademik. Sipas kriterëve studenti depoziton kërkesën pranë departamentit për tu listuar në listën e studentëve për mbrojtje diplome. Në kërkesë ai parashtron temën e diplomës brenda fushës së studimit dhe propozon pedagogun udheheqës. Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat e studentëve, mbi bazën e të cilave harton listën e studentëve që plotësojnë kriteret për të përgatitur një punim diplome dhe udheheqësin dhe ja paraqet për miratim Dekanit të Fakultetit. Drejtuesit e temave të diplomës për të gjithë studentët e listuar që plotësojnë kriteret, miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Format i paraqitjes së punimit të diplomës është përcaktuar në rregulloren e diplomimit. Ndërkohë për studentët me provim formimi, njësia bazë përgatit tezën e provimit me një ushtrim kompleks apo rast studimor me njohuritë kryesore të profilit. <i>Rekomandojmë hartimin e programit të provimit të formimit, ku për nga vetë emërtimi duhet të jenë të pranishme kërkesa nga lëndët e formimit karakterizues e të profilit dhe teza të paraqesë kërkesa edhe me njohuri nga kto fusha.</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Referuar rregullores së institucionit, të njësisë kryesore, si dhe rregullores së diplomimit, cikli i dytë i studimeve Master Profesional përmbyllet vetëm me raportin përvojës profesionale dhe mbrojtjen e diplomës ose provimin e formimit, <i>Respektimi i kërkesave të këtij kriteri edhe një herë konfirmon nevojën zbatimit të rekomandimit të dhënë në kriterin 2.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Edhe kërkesat e këtij kriteri rikonfirmojnë pëshe më të madhe të numërit të studentëve në përgatitjen e diplomave. Nga takimet me studentet dhe stafin, GVJ konstatoi që udheheqësi i punimit të diplomës orienton dhe ndihmon studentin për përgatitjen e temës së diplomës. Se bashku përgatisin programin e punës së studentit, afatet gjatë të cilave ndihmohet dhe kontrollonhet puna e bërë sipas programit të miratuar.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	GVJ vlerësoi nga takimi me studentët se ata e përdorin shumë pak bibliotekën e institucionit. Laboratorët e teknologjisë së informacionit kanë mjedise të mjaftueshme dhe kompjutera të cilat studentët e këtij program studimi, mund t'i përdorin për përgatitjen e temave të diplomave.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi	Nga verifikimet dhe vizita në institucion u konstatua se pedagogu udheheqës i temës përgatit metodikën e studimit për realizimin e temës së diplomës dhe mbi bazën e saj organizohet e gjithë puna kërkimore që duhet të kryejë studentin, duke i dhënë atij të gjithë asistencën e nevojshme për realizimin e punimit të diplomës nga fillimi i kërkimit deri në shkrimin e raportit të punimit, duke garantuar në këtë mënyrë cilësinë e tij.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.									
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Studentët vlerësohen me notë për provimin e formimit ose mbrojtjen e diplomës dhe kjo pasqyrohet në procesverbalet që depozitohen në sekretarinë mësimore. <i>Aneksi 5_Rregullore e Institucionit_TBU, neni 22.</i> <i>Aneksi 14 Dosja e plote e programit te studimit me elementet perberes te tij.</i>								
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të studimeve në këtë program studimi, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës. <i>Aneksi 15.1_Modeli i diplomes dhe Urdheri i aprovimit_MP_AB.</i> <i>Aneksi 15.2_modeli_suplementi_diplomes.</i>								
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	<i>Nga vizita në institucion e GVJ dhe shqyrtimi i rregullores se institucionit nuk rezulton qe studentit ti vihen në dispozicion kopje e plote zyrtare e programit të studimit.</i>								
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se dokumentacioni për studentët ruhet për një kohë të pacaktuar nga institucioni në hard-copy edhe në database që disponon TBU- Sugjerojmë që edhe database online të pasurohet me elementë sigurie dhe të dublohet edhe me hardcopy. <i>GVJ konstatoi që dokumentacioni për studentët në vite është i plotë por ka student të vitit të kaluar ende të pamatrikulluar. Sekretaria na vuri në dispozicion kërkesën që ka bërë per matrikulimin e studentëve.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të	GVJ konstatoi se TBU, në lidhje me këtë program studimi, disponon të dhënat për ç'do semestër, për ç'do vit akademik, të stafit akademik që përfshihet në program. Në këto të dhëna përcaktohen edhe lëndët që

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>mbulon secili anëtar i stafit akademik si dhe statusin e tij.</p> <p>Nga konsultimi i dosjeve të stafit të programit, GVJ evidenton se në dosjet e perzgjedhura në mënyrë rastësore gjendet dokumentacioni si, librezë pune, kontrat e punës, diploma dhe lista e notave të noterizuara të studimeve universitare, masterit, doktorata, CV, etj</p> <p><i>Aneksi 20_CV_Stafi Akademik Programi MP_AB 60 ECTS.</i> <i>Aneksi 23_Te dhena Tabelore pers.akad. njesia kryesore_njesia pergjegjese.</i> <i>Aneksi 24_Te dhena tabelore personeli akademik i programit.</i></p>			
<p>Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, GVJ evidentoi se TBU ka rregullore për përcaktimin e rregullave bazë për punësimin, vlerësimin dhe largimin nga puna të personelit akademik dhe ndihmë-sakademik të njësive bazë, si dhe personelit administrativ në TBU. Kjo rregullore mbështetet në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligj që në vijim do të përmendet me shkurtimin LAL, në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë si dhe në Statutin dhe rregulloren e përgjithshme të TBU.</p> <p><i>Aneksi 11. Rregullore e punesimit.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Në vizitën që GVJ pati në institucion, stafi i burimeve njerëzore shprehet se vendet vakante për personel akademik apo administrativ bëhen publike në faqen e ëeb. Sipas tyre, ndër kandidatët për personel akademik efektv apo të ftuar, përzgjidhen më të mirët, duke synuar jo thjesht formimin akademik por mbi të gjitha profesionalizmin, eksperizën dhe eksperiencën në fushat përkatëse ku ata edhe do të angazhohen në mësimdhënie. <i>Por GVJ nuk mundi të verifikonte sesi këto procedura aplikoheshin</i></p> <p><i>Aneksi 47. Te dhena nga faqja zyrtare ëeb/link 13 Punësimi në TBU</i></p>			
<p>Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ, konstaton se TBU ka një procedurë në të cilën identifikohen, kriteret e përgjithshme dhe specifike për rekrutimin e personelit, sipas ligjeve në fuqi por GVJ nuk mundi të verifikonte sesi këto procedura aplikoheshin, kush aplikonte, si bëhej vlerësimi i tyre dhe si përzgjidhej apo nëse bëheshin publike këto procedura GVJ nuk konstatoi mekanizma të bërjes publike të këtyre kritereve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.2				
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Referuar dokumentacionit, vizitës në institucion, takimeve me stafin akademik dhe administrativ, GVJ konstaton se TBU angazhohet për krijimin e mjedisit të përshtatshëm për personelin. Kështu në godinën e institucionit, ka zyra për personelin akademik me kohë të plotë, një ambjent për personelin akademik të ftuar sikurse edhe zyra për personelin administrativ. <i>Aneksi 42. Mjediset e Fakultetit AB.</i>			
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni por edhe gjatë vizitës në institucion, nuk evidentohet ndonjë mbështetje financiare ndaj stafit akademik dhe administrative për për kualifikim të mëtejshëm, në lidhje me metodat innovative, pjesëmarrjen në konferencat të cilat organizohen, duke ndjekur politikën e pjesëmarrjes pa pagesë për ta. <i>Ndërkohë GVJ sugjeron politika më proaktive mbështetje, vendosjen e sistemeve motivuese e stimuluese të pjesëmarrjes në konferenca nderkombëtare prestigjioze apo botimet në revista shkencore prestigjioze të fushës së ekonomisë.</i>			
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Nga takimet me stafin akademik, rezulton se TBU, organizon trajnime/ ose leksione të hapura për metodat innovative të mësimdhënies, por gjithsesi GVJ nuk evidentoi ndonjë evidencë për të dokumentuar këtë, as në RVB dhe as në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni. Në anekse të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni, konkretisht në Aneksin 46. <i>Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit</i> nuk gjendet konkretisht ndonjë udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit, por një material i përkthyer në lidhje me mësimdhënien dhe mësimnxënien me titullin <i>Për Zhvillimin dhe Përdorimin e Metodave të Ndryshme dhe Inovative të Mësimdhënies Tirana Business University College.</i> <i>GVJ rekomandon rritjen e mundesimit të kualifikimit të mëtejshëm për metodat innovative të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjive të reja.</i> <i>Aneksi 46. Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit.</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Nga i gjithë dokumentacioni i DVV është evidente që institucioni dëshmon një angazhim të plotë të burimeve njerëzore, për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. <i>Aneksi 24. Te dhena tabelore personeli akademik i programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>TBU siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. Infrastruktura është e përshtatshme e pajisur me salla leksioni dhe seminari, laboratore dhe bibliotekë.</p> <p>Referuar RVB, vizitës në institucion dhe të dhënave për infrastrukturën, GVJ konstaton se institucioni disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimit e mësimin të programit të studimit. Në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni evidentohet gjithashtu edhe raporti i MASR për verifikimin e kapaciteteve pritëse për vitin akademik 2019-2020, ku konkludohet se institucioni i përmbushet detyrimet ligjore për kapacitetet pritëse.</p> <p><i>Aneksi 42. Mjediset e Fakultetit AB</i> <i>Aneksi shtese 15. Raporti inspektimit te kapaciteteve_MASR_19-20.</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, konstaton se në funksion të cilësisë së mësimdhënies institucioni ka aktualisht 1 laborator IT.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi fizikisht, laboratorin që TBU disponon. GVJ, sygjeron përdorimin e laboratorëve, në lëndë të vecanta të kontabilitetit dhe financës, duke përdorur softëare në lidhje me to. Duke qenë se është një program studimi master profesional, GVJ gjykon se të mësuarit të programeve specifike për mbajtjen e financës dhe kontabilitetit të kompanive, do ta bënte më të vlefshëm dhe më atraktiv këtë program studimi.</p> <p>Sallat e leksioneve dhe seminareve për këtë program studimi janë të pajisura me kompjuter dhe vidioprojektor, si edhe me tabela për të mundësuar një proces mësimdhënie efektiv.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p><i>Aneksi 42. Mjediset e Fakultetit AB.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p><i>Aneksi 42. Mjediset e Fakultetit AB.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me</p>	<p>Praktika profesionale zhvillohet pranë bizneseve ku studentët janë të punësuar ose me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi. Në fund të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	<p>praktikës, studenti vlerësohet paraprakisht edhe nga përfaqësuesi i kompanisë ku është zhvilluar praktika sipas aktiviteteve përkatëse.</p> <p><i>Aneksi shtese 18. Rregullore per praktikën mësimore.</i> <i>Aneksi 32. Tabele permb. institucionet bashkepunuese</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>Për realizimin normal të të gjithë procesit mësimor, TBU vë në dispozicion të studentëve, pa pagesë, bibliotekën mësimore, në mënyrë që të sigurojë pjesëmarrje të gjerë të studentëve dhe mundësi të barabartë për të gjithë studentët. Biblioteka mund të përdoret nga studentët pa kufizime gjatë orarit zyrtar që biblioteka qëndron e hapur (9.00-21.00). Biblioteka disponon vende të mjaftueshme për studentët dhe u ofron atyre mundësinë për të studjuar, për të përdorur literaturën mësimore bazë apo ndihmëse duke përdorur kompjuterat që biblioteka disponon ose kompjuterat personalë.</p> <p><i>Aneksi shtese 16_ Plani per Biblioteken.</i> <i>Aneksi 45_Database e teksteve Biblioteka.</i></p>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	<p>Gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit, si edhe bazuar në dokumentacion, GVJ konstatoi një fond librash fizike, periodike, revista në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj për fushën ekonomisë. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në bibliotekë disponohet literatura e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Biblioteka ka vende leximi dhe kompjutera për punime dhe kërkime shkencore.</p> <p><i>Aneksi 45. Database e teksteve Biblioteka</i></p>
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	<p>Përveç bibliotekës fizike, TBU disponon edhe bibliotekën online (EBSCO) e cila disponon një mori titujsh që përdoren për literaturë ndihmëse. Studenti ka akses në revista shkencore, libra dhe botime të lidhura me fushën e tij të interesit. Biblioteka pajiset në mënyrë të vazhdueshme me botime periodike si dhe siguron akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë.</p> <p>Këto materiale janë në dispozicion të të gjithë studentëve dhe mund të përdoren në cdo kohë prej tyre.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<i>Aneksi shtese 16. Plani per Biblioteken.</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka ka vende leximi dhe kompjutera për punime dhe kërkime shkencore dhe është e integruar me laboratorin e IT. <i>Aneksi 42. Mjediset e Fakultetit AB</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Bazuar në dokumentacion, në fillim të vitit akademik, biblioteka pasurohet me tituj botimesh të reja në varësi të lëndëve të programit të studimit për literatuën bazë ose ndihmëse, sipas syllabusit. <i>Aneksi shtese 16. Plani per Biblioteken.</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Biblioteka mund të përdoret nga studentët pa kufizime gjatë orarit zyrtar që biblioteka qëndron e hapur (9.00-21.00). Biblioteka disponon vende të mjaftueshme për studentët dhe u ofron atyre mundësinë për të studjuar, për të përdorur literaturën mësimore bazë apo ndihmëse duke përdorur kompjuterat që biblioteka disponon ose kompjuterat personalë.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ referuar rregullores së TBU, konstaton se të dhënat në TBU mbahen në regjistrat manualë. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi mbajtjen e regjistrave manual nga sekretaria mësimore në lidhje me studentët e programit. Referuar takimit të zhvilluar me stafin e burimeve njerëzore, rezulton se zyra e burimeve njerëzore administrohet të dhënat dhe dokumentacionin për aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, dhe personelit administrativ. Këto të dhëna rezultuan të jenë kryesisht manuale.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Referuar takimit me studentët, rezulton se studentët duhet të drejtohen në sekretarinë mësimore nëse kanë nevojë për informacion në lidhje me progresin dhe vlerësimet e tyre në lëndët respektive. Gjatë takimit që GVJ pati në institucion, evidentoi se komunikimi dhe informacioni mund të jepet përveçse në prezencë fizike edhe nëpërmjet email ose në faqen ëeb. Por nuk ka ende një sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave. TBU është duke e testuar një sistem të tillë. <i>GVJ sugjeron implementimin e një sistemi informacioni të integruar, për</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	<i>menaxhimin e data bazës për të dhënat e studentëve, për vlerësimet e tyre dhe që vetë studentët nëpërmjet kredencialeve të tyre të kenë informacion në lidhje me progresin dhe vlerësimet e tyre në lëndët respektive. Gjithashtu ky sistem informacioni mund të shërbejë për menaxhimin e gjithë data bazës në vite për stafin akademik, ndihmës akademik, personelit administrative, duke nisur që prej procedurave të konkurrimit, seleksionit, rekrutimit, ndryshimet vit mbas viti etj.</i>			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Duke qenë se numri i stafit akademik, joakademik dhe i studentëve është i vogël, deri tani arrihet të monitorohet aktiviteti akademik e administrativ, por <i>GVJ rekomandon implementimin e një sistemi të integruar të menaxhimit të informacionit, i cili garanton monitorim dhe siguron raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese, titullarët apo ekspertët e jashtëm.</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Në këtë mënyrë institucioni do të siguronte një dokumentim dhe formalizim më të mirë të proceseve administrative, për të dëshmuar dhe gjurmuar proceset e realizuara, problem që u identifikua gjatë vizitës në institucion. <i>Aneksi 5. Rregullore e Institucionit TBU. Aneksi 9. Rregullore për sekretarinë mësimore. Aneksi shtese 19. Rregullore per arkivin.</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	GVJ evidenton se TBU, publikon në faqen e internetit të dhëna në lidhje me programet e studimit që ofron, personelin akademik sikurse edhe të gjitha aktivitetet që organizon. Të dhënat ofrohen në dy gjuhë, në shqip dhe në anglisht. <i>Aneksi 47. Te dhena nga faqja zyrtare ëeb, link 17, 19</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ, bazuar në RVB si edhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni konstaton se institucioni harton raport financiar të të ardhurave dhe kostove për këtë program studimi. Ky raport është i përvitshëm sikurse edhe bëhet parashikimi për vitet pasardhëse. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. Gjithashtu institucioni harton edhe një plan të financimit për programin e studimit i cili përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit i cili është vetëm nga tarifat e studimit dhe shpenzimet që janë për personel akademik, personel jo akademik, qera dhe amortizim.
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Në planin financiar të pasqyruar nga institucioni nuk pasqyrohen dhe nuk parashikohen shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line etj.</p> <p>Institucioni në mbyllje të ciklit të studimit, harton raporte financiare për 3 vitet e fundit sikurse edhe harton dhe parashikon planin financiar për 5 vitet e ardhshme.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>				
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p><i>TBU. RVB Programi Master Profesional i Avancuar AB 120. Aneksi 49. Te dhena nga raporti financiar vjetor.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>GVJ duke ju referuar RVB, si edhe të dhënave nga raporti financiar, konstaton për një qëndrueshmëri financiare të institucionit. Kjo duke parë që shpenzimet për këtë program studimi, mbulohej totalisht nga të ardhurat e siguruar nga tarifat e studimit dhe madje parashikimi për 5 vitet e ardhshme është një rritje e të ardhurave të siguruar nga ky program studimi.</p> <p><i>Aneksi 49. Te dhena nga raporti financiar vjetor</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




				X
--	--	--	--	----------

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Në përcaktimin e kriterëve pranuese të Master Profesional në Administrim Biznesu i Avancuar me profile, Kontabilitet-Financë, Menaxhim dhe E drejte Biznesi, institucioni ndjek të njëjtën praktikë që zbatohet edhe për programet e tjera të studimit. Procedurat dhe kriteret e pranimit në këtë program studimi, janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me politikat e institucionit.</p> <p>Procedurat për hyrjen dhe ndjekjen e programit i referohen dhe respektojnë barazinë dhe të drejtat për cdo student. Të gjitha procedurat e shoqërojnë studentin përgjatë programit.</p> <p>Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloren e institucionit si edhe në rregulloren e programit të studimit dhe procesi ndiqet në të gjitha njësitë përkatëse për miratim (njësi bazë, njësi kryesore, rektorat, senat akademik, MASR) dhe janë në dispozicion të publikut në faqen elektronike zyrtare të TBU. Shpallja e fituesve për këtë program studim bazohet në udhëzimet e MASR si përsa i përket afateve ashtu edhe për dokumentacionin që nevojitet për regjistrim. Studentët fitues përzgjidhen duke u bazuar vetëm në kriteret e përcaktuara në vendimin e Senatit Akademik të TBU.</p> <p><i>Aneksi 2. TBU Statuti.</i> <i>Aneksi 5. Rregullore e Institucionit TBU.</i> <i>Aneksi 7. Rregullore e programit të studimit mp I avancuar_ab_120_final.</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>6 muaj para fillimit të vitit akademik, institucioni i dërgon për miratim MASR kuotat si edhe kriteret për programin e studimit. Kriteret e pranimit miratohen me vendim të Senatit Akademik të TBU, bazuar në propozimet e Departamentit përgjegjës të programit dhe Fakultetit të Administrim Biznesit. Kriteret dhe kuotat, publikohen në faqen elektronike zyrtare të TBU.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes</p>	<p>Nga takimi i GVJ me stafin akademik, pedagogët u shprehën se studentët njoftohen në rrugë zyrtare nëpërmjet publikimeve në faqen elektronike zyrtare të TBU dhe në rrjete sociale si edhe komunikime informale që pedagogët zhvillojnë me studentët në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik me studentët potencial për të ndjekur këtë program studimi. Në takimin që GVJ pati me drejtuesin e departamentit, por edhe me studentët e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	këtij programi studimi, u konstatua se përvec kriterit të mesatares për studentët aplikues, rëndësi ka edhe intervista që kandidatët bëjnë. Por gjithsesi GVJ, gjatë vizitës në institucion nuk evidentoi asnjë evidencë të dokumentuar për pjesën e intervistës që kandidatët bëjnë.			
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.				
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	<i>Aneksi 5. Rregullore e Institucionit_TBU.</i> <i>Aneksi 7.Rregullore e programit të studimit mpi avancuar_ab_120_final.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Ky program studimi është program i hapur për të gjithë ata studentë që zotërojnë diplomë Bachelor të shoqëruar me suplementin e diplomës, shqiptare ose të huaj, sipas standardit dhe rregullave të vendosura nga MASR, si dhe për studentët me transferim. Nga takimi i GVJ me përgjegjësin e departamentit përgjegjës për këtë program studimi, u konstatua se studentët e këtij programi studimi, informoheshin në mënyrë të vazhdueshme për programin e studimit, objektivat e tij si dhe kompetencat e pëfituara në përfundim të tij. Gjithashtu numri i vogël i studentëve, krijon mundësinë për komunikime të vazhdueshme me ta. Gjithashtu ç'do informacion në lidhje me programin e studimit jepet edhe në faqen ëeb të institucionit. Po kështu vënia në dispozicion të studentëve të syllabuseve si dhe kriteret për kalimin nga një vit në tjetrin plotësohet nga stafi i angazhuar në këtë program studimi dhe sekretaria mësimore. Nga sa më sipër GVJ konstaton që kriteret plotësohen, institucioni është i pajisur me strukturat përkatëse si dhe me procedurat e rregulluara dhe zbatuara nga strukturat përgjegjëse për këtë program studimi. Më konkretisht rregullorja e institucionit specifikon procedurat që ndiqen në rastin e njohjes së studimeve të mëparshme.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<i>Aneksi 7. Rregullore e programit të studimit mp I avancuar_ab_120_final.</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<i>Aneksi 5. Rregullore e Institucionit, TBU.</i> <i>Aneksi 47. Te dhena nga faqja zyrtare ëeb.</i>			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit. Informacioni është i detajuar në syllabusin e të gjitha moduleve të programit të studimit. Staf i gjithashtu informon studentët në javën e parë të fillimit të mësimit. <i>Aneksi 19 Syllabuset e Lendeve Master profesional i avancuar 120 ect.</i>			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Studenti njoftohet në lidhje me procedurat e diplomimit, këto kritere janë të detajuara te rregullorja e programit të studimit, si sa i përket peshës në kredite si dhe numrin e krediteve që studenti duhet të ketë para diplomimi. GVJ konstaton që për këtë program studimi, hartohen indikatorët të matshëm për vlerësimin e cilësisë së punimit të diplomës. <i>Aneksi 7. Rregullore e programit të studimit mp_i avancuar ab_120_final.</i> <i>Aneksi 10. Rregullore diplomimi.</i> <i>Aneksi shtese 13. Model flete vleresues diplomim me teme.pdf</i> <i>Aneksi shtese 14. Model flete vleresues diplomim provim formimi.</i> <i>Aneksi shtese 12. Nje model kazusi provim formimi_Mpi avanvuar_AB.</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Programi i studimeve të ciklit të dytë Master Profesional në Administrim Biznes i Avancuar, me profile, Menaxhim, Kontabilitet-Financë dhe E drejte Biznesi është program i hapur për të gjithë ata studentë që zotërojnë diplomë Bachelor, shqiptare ose të huaj, sipas standardit dhe rregullave të vendosura nga MASR, si dhe për studentët me transferim. Staf i akademik bën informimin e studentëve të nivelit bachelor që studjojnë pranë TBU për programin e studimit, objektivat, mundësitë e punësimit etj. I gjithë informacioni në lidhje me programin e studimit dhe gjithcka që lidhet me të, është publike në faqen ëeb të institucionit, sikurse herë për herë bëhen njoftime në lidhje me të në faqet sociale. <i>Aneksi 47. Te dhena nga faqja zyrtare ëeb.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët informohen në mënyra të ndryshme për strukturën e programit të studimit. Studenti mund të terheqë planin mësimor, strukturën e moduleve dhe shpërndarjen në semestra pranë sekretarisë. Ky informacion publikohet edhe në mediat sociale të TBU. Studentët informohen në vazhdimësi nga sekretaria mësimore për orarin e mësimeve dhe cdo njoftim tjetër që lidhet me procesin mësimor. <i>Aneksi 9_ Rregullore për sekretarinë mësimore.</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<i>Aneksi 47_ Te dhëna nga faqja zyrtare ëeb, link 17.</i>			
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ konfirmon se institucioni jep informacion, lidhur me programet e studimit, lëndët dhe përmbajtjen e tyre në mënyrë të hollësishme në rregulloren e programit të studimit, syllabuset e lëndëve, nëpërmjet takimeve me stafin akademik dhe ndihmes. Ky informacion gjithashtu gjendet edhe në faqen ëeb të institucionit. <i>Aneksi 7. Rregullore e programit të studimit mp I avancuar ab_120_final.</i> <i>Aneksi 19 Syllabuset e Lendeve Master profesional 120 ect.</i> <i>Aneksi 47. Të dhëna nga faqja zyrtare ëeb.</i>			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, si edhe nga takimi që pati në institucion konfirmon se Zyra e Karrierës dhe punësimit në TBU ka si objektiv informimin e vazhdueshëm të studentëve lidhur me mundësi për praktikë profesionale, punësim, aktivitete formuese, bursa studimi, konkurse, panairë, konferenca, forume, etj. Gjithshtu kjo zyrë, organizon seanca të trajnimit në grup dhe këshillim individual për procese të lidhura me orientimin dhe zhvillimin në karrierë (përgatitja për intervistë punë, hartimi i CV-së dhe letrës së motivimit, ndërtimi i një profili profesional në LinkedIn, etj.) Objektiv i kësaj zyrë është gjithashtu konceptimi, planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve formuese (leksione, seminare, trajnime, etj) për tema që lidhen me përmirësimin e aftësive ndërpersonale, teknike, etj. <i>Aneksi 12. Rregullore Zyra e Karrieres TBU.</i>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Nga takimi me studentët GVJ konstaton se ata informohen në mënyra të ndryshme për strukturën e programit të studimit. Studenti mund të terheqë planin mësimor, strukturën e moduleve dhe shpërndarjen në semestra pranë sekretarisë. Ky informacion publikohet edhe në mediat sociale të TBU. Studentët informohen në vazhdimësi nga sekretaria mësimore për orarin e mësimave dhe cdo njoftim tjetër që lidhet me procesin mësimor. Informimi i studentëve në lidhje me asallat e mësimin, bibliotekën e gjithcka tjetër që lidhet me realimin e programit të studimit bëhet në fillim të vitit akademik.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	Informacioni në lidhje me programin e studimit bëhet i aksesueshëm nga studentët nëpërmjet postës elektronike dhe nga publikimet në faqen elektronike zyrtare të TBU. Megjithatë në RVB dhe dokumenta të tjerë të paraqitur nga institucioni nuk paraqiten evidence për sistem të brendshëm menaxhimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet si dhe diplomimet në strukturat përkatëse. Këto të dhëna disponohen nga sekretaria mësimore e cila i percjell ato te koordinatori i programit të studimit dhe në zyrën e ALUMNI.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Duke konsideruar se ky program studimi ka filluar aktivitetin e tij në vitin akademik 2017-2018, pas ristrukturimit të masterit 90 kredite, nuk është e mundur që të ndërtohen raporte krahasuese mbi cilësinë e studentëve.</p> <p>Referuar dokumentit (<i>S.3_Numri i studentëve në total dhe i ndarë sipas profileve për vitin akademik 19-20.</i>), viti akademik 2019-2020 rezultojnë te regjistruar në total 30 studentë (14 në profilin “E drejtë biznësi”, 5 në profilin “Kontabilitet-Financë”, 11 në profilin “Menaxhim”.) Mesatarja në hyrje është 7.04.</p> <p>Për ç’do student sekretaria mësimore disponon dosjet e studentëve, të cilat përmbajnë të dhënat që nga rregjistrimi, ndjekja e studimeve deri në përfundim/diplomim të tyre.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Të dhënat statistikore menaxhohen kryesisht nga sekretaria mësimore, koordinatori i programit të studimit dhe zyra e ALUMNI si edhe Zyra e Karrierës dhe Punësimit.</p> <p>Departamenti përgjegjës i programit të studimit, në fund të ç’do viti akademik, harton raport në lidhje me analiën e përmbushjes së objektivave të programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>				
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p><i>S.3_Numri i studentëve në total dhe i ndarë sipas profileve për vitin akademik 19-20.</i></p> <p><i>Aneksi 27. Cilesia në hyrje dhe dalje studente MP i avancuar_AB.</i></p> <p><i>Aneksi 38. Analize e realizimit te objektivave Programi Studimit Master Profesional i avancuar 120 Ab_ 18-19.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Studentët janë të përfaqësuar në organet vendimmarrës të TBU sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Ata janë anëtar me të drejtë vote dhe me të drejta të barabarta me përfaqësuesit e personelit akademik.</p> <p>Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - -Senatin Akademik të TBU; - -Komisionin e Cilësisë në nivel Institucional dhe njësi kryesore; - -komisione të përhershme si NJBSC;
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Gjithashtu TBU, nëpërmjet NJSBC, organizon pyetësorë për studentët për të bërë vlerësimin e cdo lëndë dhe cdo pedagogu për lëndët përkatëse. Në këtë proces anketimi, studentët janë të lirë të shprehin mendimin dhe opinionin e tyre dhe mbetën anonim.</p> <p><i>Aneksi 30. Të dhëna tabelore për sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i> <i>Aneksi 40. Pyetësori i studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Institucioni e ka parashikuar në rregulloren e institucionit ngarkesën e lejuar për të gjitha programet e studimit dhe ky program studimi respekton të njëjtën rregullore.</p> <p>Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është në përputhje me aktet nënligjore (jo më tepër se 25 orë në javë) dhe parashikon 6 deri në 16 orë mësimore në javë në auditor. Për programet Master numri minimal i orëve mësimore që zhvillohen në auditor në një ditë është 3 orë dhe maksimale 4 orë ndërsa numri i orëve mësimore në javë luhet në intervalin 6- 16 orë mësimore. Mësimi, si rregull, zhvillohet mbasditë.</p> <p>Njohja e krediteve nga studime të mëparshme zhvillohet nga komisioni i transferimeve i cili përcakton përputhshmërinë e tyre me lëndët e ofruara në këtë program studimi.</p> <p><i>Aneksi 5. Rregullore e Institucionit TBU.</i> <i>Aneksi shtese 20. Shembull vendim ekujivalentimi Mp_AB_60.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>TBU, nëpërmjet NJSBC, organizon pyetësorë për studentët për të bërë vlerësimin e cdo lëndë dhe cdo pedagogu për lëndët përkatëse. Në këtë proces anketimi, studentët janë të lirë të shprehin mendimin dhe opinionin e tyre dhe mbetën anonim. Rezultatet e pyetësorit merren në konsideratë dhe kontribuojnë në përmirësimin e mësimdhënies.</p> <p><i>Aneksi 40. Pyetësori i studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të</p>	<p>TBU ka parashikuar në rregulloren e tij procedurën që siguron ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës. Këto rregullore janë aplikuar edhe në këtë program studimi.</p>

rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<i>Aneksi 5. Rregullore e Institucionit TBU.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Institucioni është pajisur me struktura të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve. Sekretaria mësimorë është njëra prej njësive në institucion në shërbim të informimit të studentëve për procesin mësimor, orarin etj. Gjithashtu në TBU është funksionale edhe Zyra e Cështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, si edhe Zyra e Alumnit. <i>Zyra e cështjeve studentore dhe këshillimit të karrierës është përgjegjës për:</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<ul style="list-style-type: none"> • procesin e këshillimit të karrierës; • ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve; • mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni; • krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për zhvillimin e praktikës së studentëve; • krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi punësimi për studentët; • organizon aktivitete për studentët; • organizon trajnime, seminare, Ëorkshop-e, etj;
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Për programin e studimit Master Profesional Administrim Biznesi i Avancuar, me profile, informimi i studentëve për mundësitë e punësimit, trajnimet dhe kontaktet me studentët e diplomuar, një rol të rëndësishëm luan bashkëpunimi i ngushtë me biznesin. Punësimi i pjesës më të madhe të studentëve që kanë ndjekur këtë program studimi është një tregues suksesi për programin. <i>Aneksi 9. Rregullore për sekretarinë mësimore.</i> <i>Aneksi 12. Rregullore Zyra e Karrieres TBU.</i> <i>Aneksi 29 Te dhena tabelore permbledhese per punesimin real te studenteve.</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Institucioni është i pajisur me strukturat që garantojnë monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së brendshme duke përfshirë edhe këtë program studimi. Njësia përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë është në përputhje të plotë të misionit të institucionit. NJSBC si strukturë, është e përcaktuar në Statutin e TBU. Kjo njësi ka për detyrë garantimin e cilësisë së brendshme të TBU dhe të programeve që ofrohen prej tij, në përputhje me standardet kombëtare. Komisionet e cilësisë janë ngritur në nivel institucional por edhe në nivel fakulteti. <i>Aneksi 2. TBU Statuti, neni 27</i> <i>Aneksi 8. Rrregullore e NJSBC.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorët e ekspertët të jashtëm.	Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët. Monitorimi i sigurimit të cilësisë funksionon edhe në rang fakulteti. Kjo njësi monitoron kryesisht cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor. <i>Aneksi 30. Të dhëna tabelore për sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i> <i>Aneksi 8. Rrregullore e NJSBC.</i>
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit,	TBU përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	<i>Aneksi 18. Plotesimi i rekomandimeve nga akreditimi i meparshem _MP _AB_60.</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjseve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Veprimtarinë e saj NJSBC-ja e mbështet në dokumentin strategjik (<i>Aneksi 8. Rrregullore e NJSBC</i>). GVJ duke u bazuar edhe në dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion nga institucioni <i>evidenton se NJSBC harton një plan kalendarik në të cilin parashikohet plani i veprimit, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse.</i> Në mënyrë periodike NJSBC informon drejtuesit e njëjseve, e përmes tyre të gjithë stafin e TBU rreth rezultateve të monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njëjseve të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjseve të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	NJSBC-ja vepron në nivel institucional dhe është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në të gjithë programet e studimit. Në funksion të garantimit të cilësisë, rol të rëndësishëm përveç NJSBC-së ka dhe Departamenti si njësi përgjegjëse për programin e studimit. Në programin e studimit Master Profesional në Administrim Biznesi i Avancuar, një kontribut të rëndësishëm në monitorimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programit të studimit ka dhe lidhja me biznesin.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Referuar RVB, TBU, përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese. Monitorimi i realizimit të programit realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga koordinatori i programit.
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, <i>NJSBC siguron vetëvlerësimin periodik të TBU dhe të programeve të tij. Vlerësimi nënkupton një proces sistematik të mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave të rëndësishme sasiore dhe cilësore nga burime të shumta dhe të ndryshme rreth programeve arsimore, për qëllimin e përmirësimit të mesimnxënies së studenteve dhe vlerësimin nëse po përmbushen standardet akademike dhe të mesimnxënies.</i>
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen	GVJ bazuar në dukumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni por

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	edhe nga takimi që pati me përfaqësues të NJSBC, evidentoi se treguesit e vetëm të përdorur për ecurinë e programit të studimit është nota mesatare dhe kalueshmëria, sikurse edhe punësimi I studentëve në total dhe punësimi i studentëve sipas profilit të studimit. Instrumenti i vetëm i përdorur prej NJSBC është pyetësori për studentët për vlerësimin e pedagogut të lëndës dhe pyetësori për stafin akademik.			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Aktivitetet me karakter monitorues dhe vlerësues që organizohen nga NJSBC, për secilin nga proceset akademike që monitorohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë Dekanëve të Fakulteteve dhe përgjegjësve të Departamentit. GVJ, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit por edhe gjatë vizitës në institucion, nuk evidentoi ndonjë raport në lidhje me programin e studimit në lidhje me rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit si edhe masat e marra. Përmbledhja e vetme në dokumentacion në lidhje me këtë është vlerësimi mesatar për secilin pedagog të lëndëve nga ana e studentëve. <i>Aneksi 8. Rrregullore e NJSBC</i> <i>Aneksi 40. Pyetësori i studenteve.</i> <i>Aneksi 41. Pyetësori i stafit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Vlerësimi nga NJSBC bëhet në nivel institucional dhe si i tillë shtrihet në të gjithë programet e studimit dhe nuk hartohen relacione specifike në bazë programi, por nga analiza e përgjithshme, secili nga Departamentet përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit evidenton elementët që lidhen me programet specifike. Këto vlerësime janë pjesë e vetëvlerësimeve në kuadër të akreditimit.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Për kryerjen e vlerësimit dhe monitorimit të këtij programi studimi, strukturat përgjegjëse përdorin instrumenta të përdorur edhe në programe të tjerë studimi në TBU. Të dhënat ofrohen nga sekretaria mësimore për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, monitorimi i realizimit të aktiviteteve të programit të studimit, opinionin e studentëve dhe personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie. Ndërkohë që kryhet edhe anketimi i studentëve dhe personelit akademik në
Kriteri 3. Institucioni i arsimit	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>nivel institucioni, njësie kryesore dhe në nivel të këtij program studimi.</p> <p>Megjithatë në RVB thuhet se NJBSC kryen vlerësime për mësimdhënien, vlerësime për kurrikulën etj, por nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni si edhe nga takimi që GVJ pati me përfaqësues të NJBSC, nuk evidentoi asnjë raport në lidhje me vlerësimet e tjera përveç pyetësorëve ndaj studentëve dhe stafit akademik.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p><i>Aneksi 8. Rrregullore e NJSBC</i> <i>Aneksi 40. Pyetësori i studenteve.</i> <i>Aneksi 41. Pyetësori i stafit akademik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të</p>	<p>Institucioni përfshin aktorë të brendshëm në vlerësimin e programit, stafin</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	që lidhet me direkt me programin e studimit në fjalë, sikurse edhe student në strukturën e NJSBC. <i>Aneksi 8_Rrregullore e NJSBC.</i>			
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Përgjegjësitë dhe detyrat që duhet të ushtrohen nga secili prej anëtarëve të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë janë të përcaktuara qartë në kryerjen e funksioneve dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara në rregulloren e kësaj njësie. Bazuar në rregullore, NJSBC, siguron vetëvlerësimin periodik të TBU dhe të programeve të tij dhe të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e vetëvlerësimit. <i>Aneksi 8_Rrregullore e NJSBC.</i>			
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Në institucion janë të përcaktuar qartë njësitë që janë përgjegjëse për këtë programin e studimit. Koordinator i programit shërben si një urë lidhëse midis biznesit dhe njësisë përgjegjëse për këtë program studimi. Po kështu kontaktet e vazhdueshme me studentët bëjnë që të gjitha palët të marrin pjesë në përmirësimin e vazhdueshëm të programit dhe përshtatjes së tij me nevojat më të fundit të tregut. <i>Aneksi 36_Vendim per emerimin e koordinatorëve te programeve MP_AB.</i>			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Institucioni përfshin aktorë të brendshëm në vlerësimin e programit, stafin që lidhet me direkt me programin e studimit në fjalë, sikurse edhe student, në strukturën e NJSBC, duke shmangur gjithashtu diskriminimin apo pabarazinë ndërmjet tyre. <i>Aneksi 8_Rrregullore e NJSBC.</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Bazuar në dokumentacion, pjesë aktive e procesit të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm janë stafi akademik dhe studentët. Për këtë proces nuk ka bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm. Në RVB, sikurse edhe në takimin që GVJ pati me përgjegjësin e departamentit përgjegjës për këtë program studimi, u evidentua që herë pas here ftoheshin përfaqësues dhe drejtues të biznesit për leksione të hapura. <i>Megjithatë GVJ nuk eidentoi ndonjë ndryshim apo përmirësim në cilësinë e programit si pasojë e mendimeve të ekspertëve të jashtëm.</i> <i>Aneksi 8_Rrregullore e NJSBC.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Standardi VI.5				
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Institucioni është i pajisur me strukturat përgjegjëse që sigurojnë monitorimin e vazhdueshëm të cilësië, megjithatë GVJ gjykon që krahas rregullores së NJSBC-së, institucioni duhet të hartojë edhe një plan pune sipas një plani kalendarik (Planit të veprimit) të përvitshëm, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse. <i>Aneksi 8_Rrregullore e NJSBC.</i>			
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Institucioni publikon rezultatet si është parashikuar në rregullore. Kështu sa i përket pyetësorëve të realizuar me studentët, rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësave të departamentit, si dhe dekanëve përkatës sikurse edhe Rektorit. <i>Aneksi 5. Rregullore e Institucionit TBU.</i> <i>Aneksi 8. Rrregullore e NJSBC.</i>			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Bazuar në RVB, sikurse edhe në takimin që GVJ pati me përfaqësues të NJSBC, evidentoi se në rast të vlerësimeve negative, synohet shqyrtimi i tyre dhe marrja e masave për përmirësim. Synimi i vazhdueshëm i TBU, është efektiviteti i veprimtarivë në kuadër të përmirësimit të cilësisë si edhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së programit të studimit.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në RVB theksohet se TBU organizon veprimtari periodike për informimin dhe ndërgjegjësimin për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë dhe që në këto veprimtari marin pjesë edhe përfaqësi nga studentët. Por GVJ, në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në vizitën në institucion nuk evidentoi ndonjë evidencë në lidhje me këtë.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




			X	
--	--	--	----------	--

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Administrim Biznesi me profile: a. Menaxhim; b. Kontabilitet - Financë” të institucionit të Arsimit të Lartë “TBU”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Marrëveshje bashkëpunimi me një numër të madh biznesesh jo vetëm për kryerjen e praktikës profesionale por edhe për punësimin e studentëve.
2. Infrastruktura e ofruar nga TBU siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. Infrastruktura është e përshtatshme dhe pajisur me salla leksioni dhe seminari, laboratore dhe bibliotekë.
3. Stafi akademik i TBU është i kualifikuar, me eksperiencë dhe me eksperizën profesionale në fushat përkatëse të mësimdhënies.
4. Pjesëmarrja e TBU në projekte dhe angazhimi i studentëve në to krijon mundësinë e kualifikimit të stafit akademik por edhe forcon frymën e bashkëpunimit midis stafit dhe studentëve.
5. Programi i studimit Master profesional, “Administrim Biznesi” me profilin Kontabilitet-Financë synon në përgatitjen e profesionistëve në këtë fushë.

Pika të dobta

1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në këtë program studimi nuk përmbush kërkesat ligjore në fuqi, më konkretisht pikës 6 të nenit 59 të ligjit 80/2015, ku thuhet se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie duhet të ketë të paktën kualifikimin e ciklit pasardhës. Për vitin akademik 2019-2020, nga stafi akademik PAE dhe PAK, i angazhuar për programin e studimit, 16 janë më titullin Msc.
2. Nuk ka një analizë të tregut mbështetur në kërkesat dhe pritshmëritë e bizneseve apo në opinionin e bizneseve dhe studentëve të diplomuar se çfarë ata shohin vështirësi në tregun e punës bazuar në programin e studimit që ata kanë përfunduar.
3. Plani mësimor nuk është i specifikuar sipas krediteve për të gjitha veprimtaritë formuese (leksione, seminare, detyra kursi, projekte etj) por shprehet vetëm në orë mësimore.
4. Plani mësimor nuk është i balancuar, ka shumë orë studim individual krahasuar me orët në auditor të studentit.



5. Vlerësimi i vazhdueshëm i studentit si edhe vlerësimi final i lëndës paraqitur në syllabuset e lëndëve nuk bëhet plotësisht konform akteve nënligjore, rregullores së institucionit si edhe rregullores së programit të studimit.
6. Mungesa e një sistemi informacioni të integruar, për menaxhimin e data bazës për të dhënat e studentëve dhe stafit.

Rekomandime

1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme I rekrutuar, që angazhohet në këtë program studimi duhet të plotësojë kërkesat ligjore në fuqi, më konkretisht pikës 6 të nenit 59 të ligjit 80/2015, ku thuhet se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie duhet të këtë të paktën kualifikimin e ciklit pasardhës.
2. Plani mësimor në të ardhmen, t'i nënshtrohet në mënyrë të vazhdueshme përmirësimeve, me qëllimin e përputhshmërisë me aktet nënligjore por edhe me kërkesat e një tregu pune dinamik si dhe për të reflektuar edhe rekomandime të ekspertëve të jashtëm, të studentëve si dhe të bizneseve partnere. Plani mësimor duhet të përfshijë me kreditet përkatëse të gjitha veprimtaritë formuese të cilat janë në syllabuse por mungojnë në planin mësimor.
3. Ngarkesa e programit të studimit duhet rishikuar për të balancuar orët në auditor dhe jashtë auditorit.
4. Vlerësimi i vazhdueshëm i studentit si edhe vlerësimi final i lëndës paraqitur në syllabuset e lëndëve duhet të bëhet konform akteve nënligjore, rregullores së institucionit si edhe rregullores së programit të studimit.
5. NJSBC duhet të hartojë, në mënyrë të posacme dhe të detajuar për gjithë aktivitetin e vet, mekanizmat e përdorur dhe identifikimin e praktikave të mira /problematikave dhe të propozojë/adresojë zgjidhje për to.
6. Institucioni duhet të përmirësojë ndjeshëm dokumentimin e vazhduar të proceseve të realizuara për përmirësimin e cilësisë.
7. Implementimin e një sistemi informacioni të integruar, për menaxhimin e data bazës për të dhënat e studentëve, për vlerësimet e tyre dhe që vetë studentët nëpërmjet kredencialeve të tyre të kenë informacion në lidhje me progresin dhe vlerësimet e tyre në lëndët respective. Gjithashtu ky system informacioni mund të shërbejë për manaxhimin e gjithë data bazës në vite për stafin akademik, ndihmës akademik, personelit administrative, duke nisur që prej procedurave të konkurrimit, seleksionit, rekrutimit, ndryshimet vit mbas viti etj.



Evaluation conclusions on 2 Years Professional Program in Business Administration (120 Ects), offered by the "Tirana Business University"

Strengths and affirmations

1. Cooperation agreements with a large number of businesses not only for professional practice but also for student employment.
2. The infrastructure provided by TBU provides sufficient and appropriate learning environments for the development of theoretical teaching activity. The infrastructure is adequate and equipped with lecture and seminar rooms, laboratories and library.
3. The academic staff of TBU is qualified, experienced and with professional experience in the respective fields of teaching.
4. The participation of TBU in projects and the engagement of students in them creates the opportunity for the qualification of the academic staff but also strengthens the spirit of cooperation between the staff and the students.
5. The professional master study program, "Business Administration" with the profile Accounting-Finance aims at preparing for a short time of professionals in this field.

Weaknesses

1. Full-time and part-time academic staff engaged in this study program does not meet the legal requirements in force, more specifically point 6 of article 59 of law 80/2015, which states that academic staff engaged in teaching must this at least the qualification of the next cycle. For the academic year 2019-2020, from the academic staff PAE and PAK, committed to the study program, most of them are with the title Msc.
2. There is no market analysis based on the demands and expectations of businesses or the opinion of businesses and graduate students on what they see as difficulties in the job market based on the study program they have completed.
3. The curriculum is not specified according to credits for all formative activities (lectures, seminars, course assignments, projects, etc.) but is expressed only in lessons.
4. The curriculum is not balanced, there are many hours of individual study compared to the hours in the student auditorium.
5. The continuous evaluation of the student as well as the final evaluation of the course presented in the syllabus of the courses is not done in full conformity with the bylaws, the regulation of the institution as well as the regulation of the study program.
6. Lack of an integrated information system for managing the database of student and staff data.

Recommendations:

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



1. Full-time and part-time academic staff recruited to engage in this study program must meet the legal requirements, more specifically point 6 of article 59 of law 80/2015, which states that academic staff engaged in teaching must to have at least the qualification of the next cycle.
2. The curriculum in the future, to be continuously subject to improvements, with the aim of compliance with bylaws but also with the requirements of a dynamic labor market and to reflect the recommendations of external experts, students or partner businesses. The curriculum should include with appropriate credits all formative activities which are in syllabuses but are missing in the curriculum.
3. The work program load should be reviewed to balance the hours in the auditorium and out of the auditorium.
4. The continuous evaluation of the student as well as the final evaluation of the course presented in the course syllabus must be done in accordance with the bylaws, the regulation of the institution as well as the regulation of the study program.
5. The Internal Quality Assurance Unit should design, in a special and detailed way for all its activity, the mechanisms used and the identification of good practices or problems and to propose and address solutions for them.
6. The institution should significantly improve the continuous documentation of the implemented processes for quality improvement.
7. Implementation of an integrated information system, for the management of the database for student data, for their evaluations and for the students themselves through their credentials to have information about their progress and evaluations in the respective subjects. Also, this information system can serve for the management of the entire database in years for academic staff, academic assistants, administrative staff, starting from the competition procedures, selection, recruitment, changes year after year, etc.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	


